Oral History Kosovo

INTERVISTË ME BEQIR MALIQIN

Stantërg | Data: 26 tetor, 2020
Kohëzgjatja: 100 minuta

Të pranishëm:

1. Beqir Maliqi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:
() - komunikim emocional
{} - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:
[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin
Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotri Beqir, nëse mundeni me u prezantu edhe me na tregu diçka për familjen e juj?

Beqir Maliqi: Unë quhem Beqir Maliqi i lindun me 12. 10. 1956. Buroj nga një familje minatorësh, babai m'punoi këtu në Minierën e "Trepçës" së Stantërg. Babai im ndjestë pastë i pati gjashtë djem e dy vajza. Si çdo fëmijë unë kom fillu në shkollë në Tunelin e Parë. Jom fëmiju i tretë i familjes. Shkollën fillore e kom kry në Tunelin e Parë këtu afër minierës. Jom nga një fshat i Shalës së Bajgorës ku në vijë ajrore rreth një kilometër e gjys nga miniera osht', prandaj edhe e kemi kry shkollën fillore në Tunelin e parë të gjithë vëllezërit dhe motra. Pastaj kom viju mësimin në gjimnazin në Mitrovicë, ku e kom kry gjimnazin atëherë quhej "Silvira Tomasini", tash "Frank Bardhi".

Pas kryerjes së gjimnazit kom tentu të regjistrohem në Fakultetin Ekonomik, por për fat atëherë nuk munda të pranohem edhe erdha në Mitrovicë edhe u regjistrova në Fakultetin Xehtaro-metalurgjik. Bile, më ka ndihmuar për t'u regjistruar atëherë profesor Minir Dushi, sepse i tregova që e kom babën minator edhe ai kishte dëshirë që unë të vazhdoj shkollimin në Degën e Xehtarisë. Kur shkova në shtëpi i tregova babës se jom regjistrue. Të drejtën me thonë tha, "Ku je regjistrue?" Thash, "Në xehtari". Po më thotë, "Eh more bir, ti nuk mundesh tjetërkund m'u regjistru sepse….", po shprehna qysh m'ka thonë, "t'kom maru me rudë, me xehe", e kish fjalën këtu të minierës edhe patë dëshirë që u regjistrova.

Fatmirësisht e kreva fakultetin rregullisht, nuk e hupa asnjë vit. Fillimisht pa diplomu punova në Shkollën e Mesme Teknike në Mitrovicë. Pastaj kur diplomova në vitin 1980 në Fakultetin e Xehtarisë fillova punën këtu {tregon me dorë}, pranë Minierës së Stantërgut.

Anita Susuri: Deshta diçka me ju pytë para se me vazhdu mandej. Ju më thatë që baba juj ka punu në "Trepçë". Çfarë kujtime keni kur vinte ai prej punës? Në çfarë gjendje ka qenë ose çka ka tregu ai për punën atëherë qysh ka qenë?

Beqir Maliqi: Të drejtën me të thonë, shumë gjona për minierën këtu unë i kom msu prej babait tim. Babai ka punu pothuajse në punën ma të vështirë, këtu ne i thojmë, "Mbushjen e skipave", domethonë aty ku e gjithë sasia e xehes që e prodhohet nga miniera, bohet mbushja atje në horizontin e poshtëm, domethonë bash ku m'ka punu babai, pastaj nga miniera nxerret xehja edhe vazhdon për flotacion. Kështu që, ai ka shpjegu gjithçka për minierë. Ai e ka pasë punën e vështirë. Disa herë është lëndu aty në punë kur ardhke te shtëpia i lëndum ka ardh dy-tri herë. Kështu që, edhe ajo ka qenë njëfarë inspirimi për mue të vazhdoj ma tutje me xehtarinë.

Po të drejtën me të thonë, ai e ka pasë një familje të ngushtë. Përpos punës që e ka bo këtu në fshat atje osht' merr edhe me punë pak, me blegtori e çka di unë. Ka pasë hjeka e vuajtje të mëdha. Ka fillu këtu punën në vitin 1947, do të thotë mas Luftës së Dytë Botërorë edhe ka punu diku në vitin… n'fund të '80-tës, rreth 32 vite ka punu këtu pranë minierës.

Anita Susuri: A ka qenë e vështirë edhe për nanën e juj, për familjen krejt qajo puna e tij?

Beqir Maliqi: Po, shumë e vështirë ka qenë të drejtën me të thonë. Tash po shprehna ashtu si ka qenë. Kur fillova punën këtu edhe shkojsha në shpi i tregojsha nanës kom hy në minierë e jom i lodhun m'thojke, "Pse edhe ti si baba yt në minierë në punë të vështira?" Thojsha, "Po nanë për me msu punën duhet me shku me vizitue atje ka punojnë e sene". Tha, "S'paske bo kurgjo!" Tha, "Kom mendu që e ke kry fakultetin e rrin në zyre me mantila e me s'e di çka". Kështu që, ka qenë shumë interesant që me njëfarë forme edhe ja ka qëllue drejtë me thonë, sepse kjo është një punë bukur e vështirë këtu pranë minierës me rreziqe të mëdha.

Anita Susuri: Çfarë kujtime keni gjatë qasaj periudhe, domethonë kur keni shku në shkollë? Po thoni që një kilometër, qysh u konë për një fëmijë qaq me ecë në shkollë?

Beqir Maliqi: Po rruga u konë e vështirë drejtë me të thonë. Fshati Kutllovc është një fshat kodrinor malor. Kështu që, ka qenë e vështirë me udhëtu. Nuk ka pasë shumë nxansa, shpeshherë vetëm, rrugë e largët. Ka qenë një përpjetëze e madhe, si verë si dimër ma u djersitun nuk ke mund me shku në shtëpi edhe pse nuk ka qenë shumë larg nga Tuneli i parë, gjysëm ore me udhëtu, por ka qenë terren i pjerrët shumë. Kështu që, ka qenë e mundimshme, ka pasë rrugës qej, ka pasë rreziqe, mal a po m'kupton? Kështu që, sidomos në shkollën e mesme kur kemi shku udhëtojshim për terr që vetëm udhëtojshim për shembull, nuk kishim kolegë të tjerë aty se kanë qenë pak shtëpi në aty fshat e kështu që ka qenë bukur e vështirë me njëfarë sakrifice n'veti ta qujmë ashtu.

Anita Susuri: Çfarë tjera detaje mundeni me na tregu për shembull, për babën e juj edhe qatë punën edhe çfarë mendimi ju keni pasë për qatë punë kur e keni pa babën në qatë gjendje?

Beqir Maliqi: Po ka qenë bukur e vështirë drejtën me të thonë sepse e kemi pasë një baba i cili është përkujdes shumë për fëmijët e vet. Na gjashtë vllaznit që jemi të gjithë jemi të shkollum, drejtë me të thonë që ka kontribu. Prej të gjashtëve vetëm vëllau i madh, i cili edhe ai ka punu 45 vite këtu në minierë, para dy viteve ka dalë në penzion prej vitin '71. Ai e ka pasë kry Shkollën e Mesme të Xehtarisë edhe ka fillu punën këtu në minierë. Në të tjerët, pesë të tjerë i kemi kry fakultetet me rradhë. Unë Fakultetin e Xehtarisë, vëllau mas meje e ka kry Arkitekturën, tjetri vëlla Elektron, dy të voglit e kanë kry Gjeologjinë, bile vëllau i vogël edhe ka doktorue në Fakultetin e Gjeologjisë edhe osht' mësimdhënës, profesor në Fakultetin e Mitrovicës.

Kështu që, për babën ka qenë shumë e vështirë kjo me investu tonë jetën për shembull me fëmijë, por në njëfarë forme edhe ju ka shpagu. Ka qenë i knaqun në fund të fundit, por ka qenë shumë baba rigoroz, nuk na ka toleru të drejtën me të thonë me bo lëvizje, me shku me humb kohën dika tjetër, n'shkollë-shpi, shkollë-shpi, shkollë-shpi. Sepse edhe te shtëpia jemi merr atje me blegtori, kemi majtë lopë, dele e kemi punu një tokë edhe pse s'ka qenë shumë pjellore, por kemi pasë pemë, kemi pasë njëfarë jete bukur t'mirë. U konë jetë e begatshme me vuajtje e hjeka të mëdha, por të gjitha i kemi pasë sepse babai e marrke një rrogë të mirë këtu edhe te shtëpia i majshim lopë e dele e kemi pasë shumë pemë në atë vend e dru ka pasë, ujë ka pasë e t'gjitha t'mirat i kemi pasë. Mirëpo, kemi punu pa ndërpre, të drejtën me të thonë, edhe prej fëmijë sa troha ja kemi nisë me punue. Në njëfarë forme me ja dhonë shtyllat shtëpisë t'gjithë jemi mundu kështu.

Anita Susuri: Shkollën e mesme thatë që e keni vazhdu pastaj. A ka pasë edhe atëherë vështirësi edhe qysh ka qenë atëherë gjatë shkollës së mesme?

Beqir Maliqi: Po në shkollën e mesme na prej fshati që shkum, drejtën me të thonë, atje si ma të tërhjekun e ndijshim vetën në atë kuptimin, por ka pasë diciplinë, ka pasë diciplinë, ka pasë mësim, ka pasë orë, ka pasë… Domethonë, nuk humbshim orë, mësojshim, e humbshim vitin. Njerëzit që nuk mësojshin, domethonënë ka pasë nivel, nivel i shkollimit, nivel i shkollimit u konë.

Anita Susuri: A keni udhëtu, a keni banu aty?

Beqir Maliqi: Jo, kom udhëtu me autobus e nxerrsha biletën. Bile baba m'thojke, "Biletën e autobusit ta nxerri, se me t'nxonë kontrolla me thonë, 'I biri i filanit kështu kështu'. E për tjerat sa t'muj me t'dhonë me hajgju tjetër kah, mirëpo biletën edhe transportin me pasë sigurtë". Edhe kështu që në fillim të mujit e nxerrshim biletën e autobusit deri në fund të mujit, pastaj në mujin tjetër edhe me rradhë kështu të gjithë vëllezërit, se përnjëherë jemi shkollu të drejtën me të thonë pothuajse.

Anita Susuri: E qysh ka qenë sistemi në shkollë atëherë? Ju keni mësu në shqip, ka pasë drejtim në shqip domethonë…

Beqir Maliqi: Po.

Anita Susuri: Për atë, domethonë për xehtari, por a keni pasë lëndë në gjuhën serbe edhe qysh ka qenë raporti?

Beqir Maliqi: Po, po të drejtën me të thonë Fakultetin e Xehtarisë mos të thom veç nja shtatë-tetë provime i kemi dhonë në gjuhën serbo-kroate, nuk ka pasë, nuk ka pasë mësimdhanësa. Kështu që, do landë që na dhojshin profesorat serbë i kemi ndëgju me serbët. Po, mirë kemi kalu, po kemi msue, na osht' dashtë me mësu shumë, osht' dashtë me mësu shumë për me arrit diçka të drejtën me të thonë, i kemi përkushtu, jemi konë qind përqind t'përqëndrum mas mësimi. Por, fatmirësisht, ne kur kemi dalë në vitin e katërt na kanë ardhë profesorët nga Shqipëria, në vitin '77, '78 mos të thom shtatë-tetë provime, shtatë-tetë profesorë ose edhe ma shumë. Ka qenë një marrëveshje mes Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Tiranës, kështu që neve na kanë dhonë mësim profesorat e Tiranës në Mitrovicë edhe i kemi dhonë provimet e ato.

Kishim shumë qef drejtën me të thonë kur i pajshim ata edhe e flitshin gjuhën ma mirë. Kështu që, jena konë të entuziasmuar nga mësimi. Po ju tregoj drejtë, kur spjegojshin e paramendojsha veten nëpër terren atje te do shpime të thella. Ka qenë atëherë profesori që na ka dhonë atje edhe… po mirë, mirë kemi kalu. Unë në vitin '80 e kom krye. Ende ishte ajo koha ma e qetë me thonë {tregon me duar} kështu edhe nga aspekti politik edhe sene.

Anita Susuri: Deshta edhe me ju pytë pikërisht për qato vite '74-tën Kushtetuta që u bo, domethonë ka fillu një jetë pak ma stabile nëse muj me thonë.

Beqir Maliqi: Po.

Anita Susuri: Qysh jonë konë për juve qato, për shoqërinë qato vitet?

Beqir Maliqi: Po ato vite për krejt popullin shqiptar të Kosovës kanë qenë shumë të rëndësishme, sepse populli shqiptar e murr njëfarë hovi, po thom në aspektin, frymoj pak ma lirshëm edhe në aspektin politik. Kështu që, prej qato viteve '74, mos të thom edhe prej '70-tës, domethonë këto gjenerata jonë që Kosovën e kanë majtë edhe Universiteti i Prishtinës por edhe Fakulteti Xehtaro-Metalurgjik i Mitrovicës por edhe tjerat nëpër qytetet tjera për shembull.

Gjeneratat që kanë dalë gjatë qatyne viteve kanë qenë gjenerata të forta, sepse kanë kry shkollim me vullnet, po me zor po kanë mësu. Domethonë, për me arrit diçka ma shumë edhe po thom edhe këto vitet pas luftës mos të thom qato gjenerata domethonë e kanë majtë edhe prodhimin këtu por edhe

nivelin e Kosovës. Po kanë dalë gjenerata të forta, sepse kanë qenë të përkushtum mas mësimit, kanë qenë njëfarë vullneti i gjithëmbarshëm i popullit të Kosovës atëherë për mësim edhe për me arrit diçka.

Anita Susuri: E juve qysh ju kujtohen qato vite? Çka keni mendu ju?

Beqir Maliqi: Gjithashtu edhe për mu, domethonë na jemi konë të përkushtum mas mësimit, mas mësimit. Nuk kemi kalu kohë të drejtën me të thonë, nuk e kemi pasë najfarë rinie ku kemi dalë e kemi bo shëtitje të mëdha e mos të thom larg qyteteve ku jemi shkollue e sene. Nuk kemi bo najfarë lëvizje. Mirëpo, interesimi edhe përkushtimi ka qenë vetëm mas mësimit, domethonë se osht' mendu që vetëm me punë e mësim e me aftësi me arrit diçka.

Anita Susuri: Thatë që në vitin '80 e keni përfundu fakultetin, në cilit vit pastaj e keni fillu punën këtu?

Beqir Maliqi: Drejtë me të thonë, unë pa diplomu e kom fillu shkollën, këtë punësimin në Shkollën e Mesme në Mitrovicë. Si kom diplomu në nëntor '80-tës, në dhjetor kom fillu punën këtu në Minierën e Stantërgut.

Anita Susuri: A u vrejshin atëherë politikat, këto ndryshimi, domethonë që a u vrejke që situata nuk është shumë stabile?

Beqir Maliqi: Po, unë fillova në vitin '80. Kështu që, menjëherë në vitin '81 të drejtën me t'thonë me demostratat e studentëve atëherë ndryshoi gjendja tërësisht. Ndryshoi gjendja, u përkeqësu për nga aspekti politik, fillun diferencimet ideo-politike, bojke njëfarë represioni në çdo hap ndaj shqiptarëve, çdo herë vinte gjendja tu u ç'rregullue. Nuk kish stabilitet, thjeshtë nuk kish. Prej vitit 1981 e këndej nuk ka pasë stabilitet sepse u keqësue situata. Politika atëherë dirigjojke, politika, Partia Komuniste. Konë dojshin edhe prej shqiptarëve e diferencojshin, "Jo ta ka qitë një pikë Komiteti", jo i largojshin, jo i skejojshin në vende t'punës, nuk iu dhoshin vende meritore. Kështu që, nuk ka qenë najfarë periudhe e mirë.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Domethonë në '81-tën kanë ndodhë edhe demostratat e studentave edhe qysh ka qenë këtu në "Trepçë" atëherë? Qysh u prit qajo prej punëtorëve këtu? Prej juve?

Beqir Maliqi: Punëtorët drejtë me të thonë këtu mirë i kanë pritë demostratat, sepse edhe kur u mbajshin tubimet punëtorët thojshin, bile m'kujtohet njëfarë punëtori thojke, "Ata janë fëmijat tonë, fëmijat tonë që po bojnë protesta". Në njëfarë forme e kanë pasë përkrahjen e minatorëve edhe studentët e mos të thom kanë marrë pjesë shumica prej tyne edhe jonë burgosë asokohe që i kanë nxon nëpër demostrata ka dy muj e tre muj e që i kanë burgos.

Po të drejtën me thonë, na si inxhinierë të ri që ishim asokohe, i kisha do kolegë këtu që ishin edhe para meje këtu. Bile më kujtohet rasti e kom pasë një shok të mirë, nji Nazmi Peci të cilin menjëherë në vitin '83... Ai vetëm se punonte e kish aftësi për minierën edhe për organizimin me punëtorët edhe për dhënjen e prodhimit të të gjitha, në njëfarë forme fillun me diferencu edhe me etiketu serbët. Bile e kanë burgosë, e kanë pasë burgosë edhe osht' konë dënue pesë vjet burg për kurgjo, veç pse punonte, pse ishte i aftë, kishte aftësi, donte të punonte këtu. Iu pengonte serbëve, u pengonte në atë drejtim dhe e patën burgos me pesë vite burg aso kohe.

Kështu që, brenda personelit tekniko-mbikqyrës këtu lindi tani njëfarë dyshimi që me punu shumë, me punu mirë e me punu për shqiptari që thuhet, sikur Nazmi Peci do të burgoseshim. Bile unë e kom pasë njëfarë forme pasoja. M'kanë thirrë Sekretariati i Punëve të Brendshme atëherë m'kanë thirrë për shembull, m'kanë marrë n'pyetje, "Ti e ki pasë shok Nazmi Pecin", "Po bre e kom pasë shok se nivel të shkollimit njejtë kemi pasë edhe kemi punu bashkarisht kështu". "Ti duhesh të ndahesh prej tij e ti duhesh…" ku ta di unë. Ka pasë ksifarë presionesh, kom pasë.

Anita Susuri: Biseda informative.

Beqir Maliqi: Biseda informative disa herë m'kanë thirrë. Dy, tri herë m'kanë thirrë në organin e punëve të brendshme në Mitrovicë lidhur me Nazmi Pecin.

Anita Susuri: A jeni frigu? Çfarë mendimi keni pasë prej qasaj se ato janë si famëkeqe qato?

Beqir Maliqi: Po jonë si famëkeqe drejtë me të thonë, sepse në atë drejtim u pajke në bazë të bisedave. Dojshin me thonë me një fjalë, "Ju punoni, por serbët mos m'i nguc", se ne majshim njëfarë qëndrimi si ndaj serbëve si ndaj shqiptarëve, njëfarë forme, lidhur me punën këtu. Po në njëfarë forme ata dojshin me të thonë që mos i ngucni pjesën e serbëve. Bile, bile, m'kujtohet tash kur kom qenë në sekretariat atje të punëve të brendshme një shqiptar ka qenë që m'ka marrë n'pyetje edhe kishte informacione të ndryshme rreth meje edhe për Stantërgun që i kishin çu njerëzit çka po di unë edhe m'patë thonë ai, ka qenë i anës të Skenderajit, por i vjetër, shumë ma i vjetër se unë. Tha, "Me moshë muj me t'pasë fëmijë", tha, "por ti qysh ja ke fillu me punu nuk bon. Unë e ti mujmë me bo muzikë e zhurëm n'qitë zyre deri sa se pengojmë atë zyrën tjetër {tregon me duar}. Në momentin që ne e pengojmë zyrën tjetër na duhet të ndalemi".

Në njëfarë forme dojke me thonë që ti me punue, por ku i pengon serbët nuk bon. "Duhet me ndryshu", tha, "ti ma s'miri e din çka duhet me ndryshu në kokën tone", tha. M'patë thonë ai, shumë interesant m'patë ardhë në atë kohë një dikush me më këshillu në organe ato të sigurisë, për shembull lidhur me qito biseda edhe me punën e Stantërgut.

Anita Susuri: Po a ka pasë arsye që ata qashtu me vepru?

Beqir Maliqi: Nuk ka pasë asnjë lloj arsye. Nuk ka pasë asnjë lloj arsye, por ata i kishin qëllimet e veta, i kishin njerëzit e vet mos të thom që dojshin me i avansue. Ti në qoftë se e majshe një qëndrim të barabartë për të gjithë i pengonte ata, i pengonte ata në çdo hap edhe tani bojshin presion kinse na po bojmë presion ndaj serbëve këtu edhe po sjellemi. Bile-bile mu m'thojshin, "Po shkon hapave të Nazmi Pecit!" (buzëqesh)

Anita Susuri: E qysh u konë puna jote këtu qato vite? Çka ke punu konkretisht?

Beqir Maliqi: Po unë kom punu prej fillimit që kom nis këtu punën si praktikant gjashtë muaj, por në njësinë e prodhimit. Pastaj pas kryerjes së stazhit të praktikantit pas gjashtë muajve jom caktu udhëheqës teknik i horizontit të gjashtë. Mas një viti apo dy jom caktu udhëheqës, drejtues i qarkullimit të ulët që i mbulojke horizontin e gjashtë, shtatë, tetë, nontë edhe të dhjetin e të njimbëdhjetin. Kështu që, masanej kom qenë drejtues i prodhimit, drejtues i krejt prodhimit domethonë.

Bile, bile kur ka ndodhë greva, unë kom qenë si drejtues, si drejtues i prodhimit aty edhe kom qenë pjesëmarrës i grevës së madhe që quhet atëherë në vitin '89, sepse dita-ditës ardhin tu u keqsu situata prej vitit '81. Kështu që, minatorët jonë si një shtresë e njerëzimit ma të përvuajtun, punën ma të vështirë që e rrezikojnë jetën e vet për familjen e për vetën, por njëkohësisht edhe për shoqërinë edhe të gjitha padrejtësistë që bëheshin asokohe Kosovës, minatorët e ndjejshin në lëkurën e vet sepse janë ma të ndjeshëm.

Paknaqësitë, torturat. E dini ka ndodh ai marshi në Prishtinë në '88-tën ku kom marrë pjesë edhe unë. Domethonë, kemi shku në kamë nga Stantërgu deri në Prishtinë atëherë për t'i mbrojtur udhëheqësinë e Kosovës që thuhej, për ta mbrojtur Kushtetutën e Kosovës.

Anita Susuri: E deshta pak me fol ma në detaje për këto sende, për qito marshet edhe për grevën. Po fillimisht po du me të pyt, si fëmijë por edhe kur ka punu baba juj edhe ma tutje, kur ka qenë hera e parë kur keni shku ju minierën me vizitu?

Beqir Maliqi: Në minierë?

Anita Susuri: Po.

Beqir Maliqi: Hera e parë kur kom shku në minierë si student i vitit të tretë të drejtën me të thonë, si student i vitit të tretë bojshim praktikë feriale këtu praktikë edhe kom shku në minierë. Bile, bile, baba u mundonte me na spjegue, nj vëlla ma i ri se unë tu i spjegu te shpia, ai vëllau ishte i gatshëm me ardh në minierë. Diku në vitin '75 apo '76 shkrun në horizontin e nontë është ajo datë në beton atje te mbushja e skipave. Me një djal të tezës që ishte mysafir te ne i patë marrë babai e i patë pru këtu në

minierë në ndrrimin e tretë, “Veç me pa, me pa minierën me vizitu qysh o gjendja se ju po kujtoni që nuk osht’ rrezik atje” e çka ta di unë që spjegojke.

Kështu që tha, “U dashke në ndrrim”, se dy vetë punojnë aty te skipet, katër orët e para njeni, katër orët e dyta njeni, “edhe unë shkova i pari atje me bo ngarkimin në skipa edhe dola aty në zyre, sepse aty ka ndriqim edhe jonë zyret nëpër horizonte”. E këta, vëllau ma i ri se unë që o, Ramiz e ka emrin edhe ai tezaku, bile ai ka punu në minierë edhe ka vdek ai tezaku para do viteve, qitash katër, pesë viteve. E tha baba, “M’u doke që po ju doket mirë se veç ka zyret aty e i kom marrë e ki kom çu nëpër vende të vështira atje nëpër minierë ku nxirret xehja edhe tri orë të tjera kom udhëtu nëpër minierë me ta”.

Kur kanë ardh te shpia tre-katër ditë s’kanë mujt m’u ngi gjumë, sepse edhe ishin lodhë edhe tani spjegojshin qysh ishte edhe qysh ish rrezik edhe qysh ish edhe për qato thojke, “Ju duhet me mësu, mos me metë si unë punëtorë atje me punu punë fizike të vështira”. Kështu që, nashta ka qenë edhe ajo një ndikim, një inspirim për mësim te unë por edhe te tjerët vëllezër, se unë atëherë student kom qenë, student i vitit të parë dikun kur kanë qenë ata në minierë.

A unë kom ardhë në vitin e tretë kur e kom bo atë praktikën. Dy javë ditë kom bo praktikë por edhe gjatë shkollimit jemi ardhë edhe këtu edhe kemi kry praktikë se na e kemi njëfarë drejtimi të përgjithshëm që nënkupton edhe shfrytëzimin nëntokësor edhe shfrytëzimin sipërfaqësor që ne i themi.

Anita Susuri: Qysh t’u ka dukë kur ke hi për herë të parë? A të ka përngja me qato që ka tregu baba, a ma keq, a ma mirë?

Beqir Maliqi: Jo të drejtën me të thonë, sado që të spjegon dikush, sado që të spjegon kur t’e përjetojsh vetë këtu mundin e hjekën. Domethonë, osht’ një diçka ndryshe. Për qato edhe i shkrun këtu, “Me fat” në hyrje e keni pa domethonë, në hyrje të minierës shkrun, “Me fat”. Me futje aty te sinjalisti na i thojmë edhe në kafaz ndryshon çdo gjo, edhe domethonë edhe frymëmarrja edhe lëvizjet edhe sidomos ata fillestarë që hyjnë për herë të parë. Shtypja e ajrit ndikon për veshë për shembull, shkurdhohen veshët thuhet. Neve na mësojshin këta ma të vjetrit që, “Përbiju ndaq me t’u çelë veshët” (buzëqesh) ose diçka. Por, njëfarë paniku t’rrokë në vetvete, njëfarë heshtje t’u shku atje e posaqërisht kur hin atje edhe në vendet e punës për shembull që jonë bukur të rrezikshme.

Punohet e të djerësitun punëtorët, temperaturat e larta, rrymimi i ajrit ka pusorja osht’ i madh për shembull, sidomos osht’ problem kur shkon ti atje nëpër vende të nxehta edhe djerësitesh e kur të dojsh me dalë osht’ rryma e ajrit e freskët, sepse hyn prej pusit kryesor rryma e freskët. Kështu që, duhet patur kujdesë për shembull që unë kom pasë këshilla prej babait, që veshu mirë edhe ruju se miniera t’han e miniera t’prishë në aspektin shëndetësor ose diçka”. Kom pasë shumë këshilla të mjaftueshme.

Anita Susuri: E qysh është dallimi kur shkon te poshtë nëpër nivelet, nëpër horizontet? Po më duket që bohet keq e ma keq. A ma vështirë a qysh osht'?

Beqir Maliqi: Jo ma vështirë po shtypja e ajrit ndikon në vesh për shembull, shtypja e ajrit sidomos edhe me shku me një thellësi ma të madhe domethonë zvogëlohet pak sasia e oksigjenit në atë kuptimin. Këtu bile thuhet deri në 400 metra, tri metra kub në minut ajër i nevojiten personit. Me shkuarjen ma shumë se 400 metra duhet katër metra kub, domethonë rritet sasia e ajrit që duhet. Mirëpo, sidomos atje në vende qorre ku nuk ka depërtim të objekteve minerore aty është temperatura se ku ka rrymim të ajrit e ka objekte lëvizë sepse miniera jonë ajroset mekanikisht me ndihmën e një ventilatorit kryesorë që ajrin e përdorur e thithë e qetë në atmosferë, kurse ajri i freskët hyn përmes objekteve, pusit kryesorë, një travebanku në tuneli e parë edhe një pusi servis i veriut e kemi {tregon me duar}.

Mirëpo, ka kapacitet të mjaftueshëm ky ventilatori kryesor diku në Fazën e parë që osht' tu punue deri në 12,000 kub në minut e ka kapacitetin. Njeni prej eletromotorëve ma të mëdhaj të ventilatorit kryesorë është 1300 kilovat, ma i madhi elektromotor në minierën e Stantërgut osht' motori i ventilatorit. Mirëpo, në ato vende qorre që po thom osht' ma nxehtë e s'ka depërtim na në xehtari edhe në shkollë e kemi mësu, po këtu praktikisht e kemi përdorë e kemi pa, bohet ajrimi seperativ, ajrimi lokal. Domethonë qitet në vend ku ka rrymim të ajrit një ventilator ma i vogël edhe e qon te balli i punës që mundet me qenë kompresiv me qu te balli i punës {tregon me duar} ose depresiv me thith ajrin e përdorur me qitë përjashta.

Anita Susuri: Viti '81 domethonë mas demostratatave u konë kyç edhe për "Trepçën" po më duket se atëherë ka dalë edhe ajo parolla, "Trepça po punon, Begradi ndërton".

Beqir Maliqi: Beogradi ndërton po.

Anita Susuri: Çka ke mendu ti? A ka qenë e vërtetë qikjo? Qysh ka qenë? Punëtorët qysh e kanë pritë këto?

Beqir Maliqi: Po nuk e kanë pritë mirë edhe ne e kemi ditë drejtën me të thonë që djersa jonë nuk osht' t'u shku vetëm në Kosovë, por shkon edhe në Beograd sepse kjo ka qenë një prej minierave ma të mëdha në Evropë, ku e ka pasë një prodhimtari deri 700 mijë tonë në vit. I ka pasë shkrijetoret domethonë ku jonë nxjerr plumbi, zinku, ari, argjenti, kadmiumi, bizmuti. Është bo finalizimi i metaleve atëherë, kurse tash nuk e kemi një gjendje të tillë domethonë. Na tash veç e nxjerrim një sasi të xehes se e bojmë përpunimin nëpër flotacione edhe shitet si gjysëm-produkt. Kurse, atëherë me atë prodhimtari aq të madhe për shembull ka pasë vlerë të madhe.

Bile, bile u thojke atëherë që kreditë Jugosllavia kur i merr pa garantu "Trepça" nuk mundet me marrë kredi. Këso bisedash ka pasë domethonë. Ka pasë nivel të naltë të prodhimit, sepse përpos minierës tonë ne e kemi pasë edhe Minierën e Novobërdës që osht' atje, e kemi pasë Kishnicën, Hajvalinë që edhe ata i kanë prodhu deri në një milion tonë në vit edhe krejt kjo është përpunue. Domethonë, ata e kanë flotacionin e vet që e kanë përpunue, mirëpo shkrirja është bo në Metalurigjinë e Plumbit në Zveqan edhe në Metalurgjinë ë Zinkut në Mitrovicë këtu në Kompleksin në Mitrovicë këtu ku e kemi. Tash nuk punojnë fatkeqësisht asnjena metalurgji.

Anita Susuri: M'tregut ma herët për marshet. Një marsh ma herët u bo për Mitrovicë fillimisht, pastaj për Prishtinë. A jonë konë kështu?

Beqir Maliqi: Jo ma s'pari u bo për Prishtinë, për Prishtinë diku i 17-ti apo 18-ti nëntor i '88-tës. Tu u rritë represioni ndaj popullit shqiptar atëherë edhe ndaj profesorëve. Thojshin, "Ata po i qesin në penzie para kohe". Minatorët thojshin, "Për me i qitë para kohe në penzion na jemi se i kemi kushtet e vështira, kështu që profesorët i kanë kushtet me punu me vazhdu ma tutje". Por, atëherë u bojke presion edhe në Universitet të Prishtinës, dojshin para kohe me i penzionu profesorët ose diçka.

Mirëpo, tu u rrit represioni i madh, tu e përjetu minatorët domethonë e zgjidhën rrugën tu i ndjek udhëheqësat atëherë të Kosovës, shkarkimet që u bojshin e në aspektin e mbrojtjes të udhëheqsisë edhe të Kosovës, minatorët jonë nisë n'kamë prej miniere këtu e në Prishtinë atje.

Anita Susuri: Qysh u konë qato ditë organizimi? Qysh e keni marrë vendimin me shku?

Beqir Maliqi: Për besë rreth organizimeve është vështirë me fol sepse vetvetiu grupet e punëtorëve t'u fol mes veti, "Kqyr çka po ndodh. Nuk durohet mo kjo!" Bojshin të kqia atëherë, drejtën me të thonë edhe ushtarët u vrishtin atëherë nëpër që shkojshin me kry shërbimin ushtarak në ushtri, kinse vetën e ka vra e ndodhshin ardhshin kufomat, fëmijat tonë, të gjitha ndikojshin edhe u kompliku situata edhe faktikisht u grumbullun problemet edhe nuk mund të themi për organizim qiky a qaj. Domethonë vetvetiu u hetojshin ato represionet që u bojshin edhe në një moment të caktum ka lindur idea që po shkojmë për t'i mbrojtur në kamë atje me rroba të punës, me helmeta në kamë këtu e në Prishtinë edhe unë jom konë pjesëmarrës. Domethonë kjo 17 apo 18 nëntor të '88-tës ka ndodh.

Anita Susuri: Qysh u konë qajo ditë? A ka pasë polici? A ka pasë na pengesë?

Beqir Maliqi: Pengesa të ndryshme ka pasë. Pengesa edhe këtu te Tuneli i Parë ka pasë, ka edhe në Kqiq atje, ka pasë edhe në Sprekonicë {tregon me duar} atje të Burgu i Sprekonicës, ka pasë në Milloshevë atje ka dalë kordoni i policisë me na pengu. Kështu që, u mundun me na spjegue. Në Milloshevë bile m'kujtohet Remzi Kolgeci atëherë ka pasë dalë, ka pasë dalë aty e kanë pa kontaktue me minatorë, por nuk ka pasë kush që i zbrapsë. Domethonë, kanë shku në kamë atje. E kanë thy kordonin në dy anën e rrugës, se në rrugë na e kishin pasë blloku rrugën policia e atëherëshme, milicia

bile që i thojshim, e nga dy anët e milicisë {tregon me duar} punëtorët arave kanë hy edhe i kanë tejkalu edhe kanë vazhdu në kamë jemi shku deri në Palestër atje në Prishtinë.

Anita Susuri: Ramiz Sadiku ka qenë.

Beqir Maliqi: Po në Palestër kemi hy edhe aty kanë dalë punëtorë kanë majtë fjalime, i kanë kritiku pse po ndodhë kështu, pse po i hjekin udhëheqësat shqiptarë ky represion, pse ku ta di unë.

Anita Susuri: A ka pasë dikush tjetër aty që ka folë? Po më duket jonë konë edhe do, për shembull politikanë edhe aktivistë të atëhershmë që kanë marrë pjesë?

Beqir Maliqi: Vallahi Kaqusha Jashari po m'doket ka folë, atëherë u konë kryetare e Komitetit po m'doket të Lidhjes të Komunistëve të Kosovës. Fort nuk m'kujtohet udhëheqësat tjerë kush kanë folë.

Anita Susuri: Çka ka folë ajo? Çka u folë a po të kujtohet?

Beqir Maliqi: Po lidhur me gjendjen tash ma konkretisht edhe ata njëfarë arsyetimi se kqyr çka po ndodh me neve e po na bojnë një presion, i kanë falenderu minatorët për përkrahjen. Në këtë drejtim domethonë është diskutu, problemet e asaj kohe që kanë qenë kryesisht.

Anita Susuri: Pastaj prej aty qysh ka vazhdu mo gjendja?

Beqir Maliqi: Tani jonë shpërnda prej aty, jonë kthy nëpër shtëpi punëtorët, por të drejtën me të thonë dita-ditës ardhke tu u acaru situata, tu u acaru, tu u përkeqësu, tu u nervozu minatorët. Bile, m'kujtohet aso kohe mas qasaj kohe kom pasë shku në minierë edhe në horizont që thom zyret, ata ishin shku punëtorët ishin shpërnda nëpër punishte atje siç e marrin orarin, por e pata taku njëfarë Mon Peci kurrë s'e harroj edhe thashë, "Po p'e kqyrim qysh po shkon situata". Tha, "O mos, punë", tha, "mo s'ka. Këtu punë mo nuk ka. Nuk durohen gjithë këto çka po ndodhin. Sa ka me shku nuk e di!" Po prej atëherë nëntori për shembull, dhjetori shkurtoj, domethonë u grumbullunë këta, nuk ditën mo minatorët çka, çka me bo meqenëse me fjalë e politikisht nuk i ndëgjojke kërkush edhe qe filloi greva.

Anita Susuri: A u ditë paraprakisht që ka me fillu m'u bo diçka ma e madhe?

Beqir Maliqi: Po osht' ditë, osht' ditë, sepse u shtojke represioni edhe e arrijke kulmin ky mllefi edhe nervozizmi i minatorëve e arriti kulmin domethonë edhe ajo vetvetiu që po thu ti, veç grupe t'u bisedu mes veti, "Kqyr çka u bo këtu keq. Kqyr çfarë tortura po ju bojnë popullit shqiptar, kqyr politikajve". Burgoseshin, malltretoheshin në forma të ndryshme. Kështu që, dalë-ngadalë ajo e arriti atë kulmin edhe shpërtheu me grevën në minierë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: A mundeni tash me fillu prej çka ju kujtohet në grevë? Qysh ka fillu? Qysh ka vazhdu? Ju çka keni pa? Çka keni përjetu? Qysh u konë krejt qajo situatë?

Beqir Maliqi: Paj, drejtën me të thonë ajo dita e parë e grevës u konë 20 shkurti, u konë ditë e hane, ditë e hane ka qenë. Në ndrrimin e parë kom qenë n'punë, kom qenë drejtues i prodhimit. I kemi pasë na i thojmë, "Zyre të qarkullimit", një zyre atje edhe kështu për herë të parë që m'ka informu njëfarë sinjalisti, m'kujtohet njëfarë Murat Latifi (buzëqesh), ka qenë sinjalist aty. Thashë, "A dulën ndrrimi?" Se në ora nji ka qenë koha kur del ndrrimi. Tha, "Jo valla nuk po dalin". "Pse?" "S'po dojnë". Nuk e kom zgjatë ma shumë e kom thirrë në horizontin e nontë një mbikqyrës u konë, ka qenë një Shyqyri Sadiku, tash është kryetar i Sindikatës, atëherë ka qenë një djal i ri edhe ka qenë mbikqyrës në horizontin e nontë.

E kom thirrë në telefon, i kom thonë, "Qysh jeni? A jeni mirë? A u lodhët? A po dilni?" "Vallahi, jo nuk po dojnë me dalë". "Pse?" "Jo, për shkak të gjendjes, për shkak…" s'mujke me zgjat muhabet, "por, me dalë nuk po dojnë". I kemi informu edhe eprorët që i kemi pasë, do drejtora këtu.

Anita Susuri: A kanë qenë serbë, a shqiptarë?

Beqir Maliqi: Jo shqiptar kanë qenë, Burhan Kavaja ka qenë Drejtor i Minierës me Flotacion atëherë. Ka qenë drejtor teknik një Ibush Jonuzi, ka qenë drejtor i prodhimit një Mensur Fejza, unë kom qenë drejtues edhe bashkëpunëtor tjerë që kemi qenë në nivele ma të ulta se unë, por kemi qenë një numër bukur i madh edhe e majtëm një kolegium na i thojmë, "zyret e fundit", atje qeshtu që s'po dalin edhe u ndamë nëpër horizonte në grupe me shku me i lutë për me dalë.

Unë m'kujtohet që m'ka ra në horizontin e gjashtë m'ka ra, dikush në nontin, dikush në tetin, dikush në shtatin, se t'gjitha horizontet jonë konë nalë fillimisht punëtorët atje edhe shkum atje me i bind kishe që s'bon e kushtet e rrethanat e shëndeti. "Vallahi jo badihava na folni, s'keni çka me thonë na e kemi vendos qitu me nejt, mos me dalë pa u realizu kërkesat tona e sene" edhe faktikisht erdh edhe ndrrimi i dytë iu bashkangjitë ndrrimit të parë edhe qashtu tani edhe ndrrimi i tretë edhe vazhdoi procedura.

Dulëm na pamundshëm kinse me i nxerr prej miniere edhe vazhdoi në qatë mënyrë. Mirëpo, masanej drejtë me thonë mas dy ditëve jonë koncentru. Ata jonë marrë vesh ndërmjet veti se kushtet në disa horizonte kanë qenë shumë të vështira, por edhe të shkepun nuk mujshin me u informue edhe me bisedu. Kështu që, me thonë ditën e dytë jonë koncentru në horizontin e nontë edhe në horizontin e tetë. Domethonë nga e gjithë miniera jonë tubu punëtorët, por drejtë me të thonë kanë qenë kushtet e vështira se numër i madh i punëtorëve, mbi një mijë punëtorë, 1200-1300 punëtorë u llogaritshin

atëherë në minierë, hapësinat e vogla. Fatmirësisht ka punue ventilatori e ajri ka qenë deri diku në nivel, por kushtet kanë qenë shumë të vështira.

Anita Susuri: A keni qëndru edhe ju aty apo keni lëvizë?

Beqir Maliqi: Kemi lëvizë. Ka pasë kohë kur kemi nejt për disa orë, por ma tepër kemi lëvizë. Po kemi shku edhe natën, i kemi kontaktu, i kemi kontrollu objektet atje minerore, sidomos rreth ajrimit po edhe kemi lëvizë. Unë të drejtën me të thonë edhe kom qenë smut. Kanë qenë një numër i madh i punëtorëve smut. Ka dita e ejte, po thom prej të hanës dikun të ejten, nuk mujshim me flejt, nuk mujshim me pushu, kushtet e vështira edhe në njëfarë forme u lodhëm kështu pa gjumë e me ngarkesa e me ku ta di unë. Bile e patëm bo një spital të improvizum mbi zyre të qarkullimit.

Unë kom qenë edhe zyret aty i bonëm, në zyren ku kom punu kom qenë i shtrim në krevat aty edhe deri që u kry greva unë kom qenë aty ratë, domethonë deri në ditën e fundit të grevës. Po kanë qenë edhe një numër i madh i punëtorëve kishin probleme me shtypjen, kishin probleme ju ajshin kamët por s'dojshin me u kontrollu. Veç u kontrollojke, qashtu i sëmurë shkojke qashtu në minierë se s'dahna prej shokëve. Ka qenë një situatë shumë, shumë e vështirë. Nuk dojshin, nuk dojshin. Smutë qashtu rrijshin e nuk kish kush i nxjerr nga miniera me dalë përjashta, sepse në njëfarë forme ishin besatu, ishin lidhë mes veti që me i realizu qëllimet e veta edhe kërkesat e veta.

Anita Susuri: Ka pasë edhe shumë që kanë ardhë me ju vizitu atëherë?

Beqir Maliqi: Ka pasë.

Anita Susuri: Ka pasë edhe vizita që jonë pranu, disa nuk i keni pranu fare. Po kur kanë ardhë për shembull çka kanë fol qata njerëz edhe kush ka ardhë?

Beqir Maliqi: Po kryesisht, kryesisht kanë ardhë edhe kishe jonë mundu me i nxjerr, me i nxjerr nga miniera. I kanë folë, kanë ardhë. Po edhe drejtorat që kanë qenë, drejtor i Kombinatit atëherë Aziz Abrashi, drejtë me thonë, ai ka qenë tonë kohën këtu edhe Burhan Kavaja edhe kanë qenë t'gjithë këtu në kontakt me minatorët. Me njëfarë forme jonë mundu me i bind me dalë t'u dyshu që po i ndodh diçka ma e keqja nga shëndeti e po smuhen edhe minatorët, sepse po thom gjithnjë kushtet kanë qenë shumë të vështira atje. Po kanë ardhë, kanë ardhë edhe politiqarë të ndryshëm atëherë të drejtën me të thonë.

M'kujtohet edhe profesori Minir Dushi ka pasë ardhë, ka pasë tentu me i nxerr atëherë. Ka pasë ardhë Azem Vllasi, ka pasë ardhë atëherë që fillimisht nuk kanë dashtë me pranu të drejtën me të thonë, por ma n'fund e kanë pranue. E kanë pranu, mos të thom qatë ditë kanë ardhë edhe politiqarë në nivel të

Jugosllavisë atëherë. Stipe Shuvari[1] ka ardhë, njifarë Radisha Gaqiq ka qenë i Serbisë, nji Jurij Bajec. Këta tretë kanë ardhë mos të thom ditën e katër apo të pestë edhe jonë hy në minierë, jonë hy në minierë në horizontin e tetë, në horizontin e tetë jom konë me ta jom shku, prej jashti jemi shku aty.

Numër i madh i punëtorëve, ato hapësirat e vogla edhe i kanë pritë minatorët aty. Nji Veli Osmani m'kujtohet që e ka pasë hap atë farë tubimin që qysh në fillim ja nisi i falenderoi për ardhjen, edhe pse tha, "Me vonesë jeni ardhë, me vonesë". Pastaj patë folë nji Avdi Uka që u konë ndër ma t'zëshmit aty që edhe ka pasë fol. Ka pasë qenë Remzi Kolgeci me ta. Bile Remzi Kolgeci ka pasë përkthye, i ka përkthy atyne m'kujtohet mirë. Stipe Shuvari ka qenë atëherë kryetar i Komitetit i Lidhjes të Komunistëve të Jugosllavisë m'doket edhe i luti me dalë, ju luti me dalë. "Unë", tha, "babën e kom pasë minatorë e po ju lus për shkak të shëndetit, jo për shkak të kushteve të fëmijëve, familjeve të juja" e s'e di çka. Ata nuk dojshin.

Bile m'kujtohet e patë marrë fjalën njëfarë Mursel Haziri, nji Mursel Haziri edhe e fliste serbishten shumë mirë. Ai ka qenë një mbikqyrës i minierës këtu e i foli atij e i spjegoi për Jugosllavi e qysh m'kujtohet për Mal të Zi qysh e kanë hiç krahun e djathtë të shokut Tito, por aq në nivel të naltë foli e rrjedhshëm serbisht, e veti, "*Šta si po zanimanju*", "Çka je me profesion?" Ky tha, "*Kopač*, [serbisht - gërmues] jom, minator", se ai mendojke mos naj jurist. Me të vërtetë, ai ka qenë një teknik i xehtarisë edhe ka qenë një mbikqyrës i minierës, por aq rrjedhshëm e fliste gjuhën serbo-kroatishte mirë sa që i la përshtypje atij që nuk osht' ky punëtor i minierës hiç.

Edhe n'qato momente drejtë me të thonë t'u folë m'kujtohet mirë (buzëqesh) një Milazim Istrefi ka qenë, një lloderist aty edhe unë ma larg se aty shumë të dendun {tregon me duar} menxi merrshim frymë. Tha, "O ikni", ja nisi njëfar britme, i ra t'fikt atij Milazim Istrefit e kapën e ndërmjet binarëve m'kujtohet në drejtim të horizontit të tetë zyrja aty e njëfarbritme, ja nisën punëtorët me bërtit e ata udhëheqsat që kenë tu fol e tu ikë njëfarë forme se u tutën që mos po ju ndodhë diçka. Menxi kanë pasë kalu nëpër punëtor e kanë pasë dal përjashta, Stipe Shuvari me qatë grupin që ke.

Anita Susuri: Ju i keni pasë edhe disa kërkesa, domethonë minatorët në përgjithësi edhe a ki pritë ti që kanë m'u plotësu qato kërkesa? A kanë qenë veç për me u ngrit vetëdija?

Beqir Maliqi: Po të drejtën me thë thonë, ata i kanë pasë tetë diku po m'duket tash nëse nuk gaboj, tetë kërkesa që kanë qenë të ndryshme prej profesorëve mos të penzionohen ose diçka. Po ndër kërkesat kryesore mos t'thom kanë qenë dorëheqjet atëherë të disa udhëheqësve shqiptarë të Kosovës. Për Rahman Morinën, Hysamedin Azemin…

Anita Susuri: Ali Shukriun.

[1] Stipe Šuvar (1936-2004) ishte një politikan dhe sociolog kroat i cili konsiderohej të ketë qenë një nga politikanët më me ndikim komunist në Lidhjen e Komunistëve të Kroacisë në Republikën Socialiste të Kroacisë gjatë Jugosllavisë dhe më vonë në Kroacinë moderne.

Beqir Maliqi: Edhe Ali Shukriun. Domethonë, kërkesa vendimtare, kryesore mos të thom ka qenë kjo që këta duhet me dhonë dorëheqje edhe gjithashtu ka qenë kërkesa e fundit që kërkesat e ktyne me shku në Kombe të Bashkume atje në nivele të nalta botnore që i pengojke gjithë ajo, "Pse po thoni domethonë m'u ndie zëri i minatorëve në nivel botëror atje". E këto kanë qenë kërkesat kryesore edhe ka ndodhë qashtu drejtë me të thonë kur kanë pranu minatorët me dalë ju kanë thonë që kanë dhonë këta dorëheqje kanë dhonë, jonë ardhë para minatorëve i kanë garantu.

Ju kanë lexue me shkrim, me vulë, se këta kanë kqyr mirë a jonë me vulë, a jonë me shkrim edhe në njëfarë forme vetëm në bazë të qasaj plotësimit të kërkesave po thom, por kërkesa kryesore për dorëheqjen e atyne minatorët kanë pranu në ditën e tetë me dalë nga miniera. Mirëpo, ato ishin konë të rrejshme. Mirëpo, minatorët në mesnatë kanë fillu me dalë. Unë drejtë me të thonë kom qenë i shtrim në zyrën time si i sëmurë edhe smut kom qenë. I kom përcjellë prej një platoje aty ka dalin, por kur kanë dalë, sepse shtatë-tetë ditë që s'kanë dalë nga miniera i kanë qitë fasha syve, menxi dalshin tu i majtë.

I kanë pritë shumë motra medicinale, kontribut të madh kanë dhonë mjekët këtu çdo herë ekipet e mjekëve kanë qenë këtu në këtë spitalin e improvizum. M'kujtohet si kryesori nji Skender Boshnjaku po m'doket ka qenë që bash mu m'ka kontrollu e sene. Aty u majke ai kolegji i tyne, merrshin vendime qysh me u punu, se është një sallë bukur e madhe ku u majshin tubimet. Aty u konë mush me kreveta të shtrim por edhe zyret përreth. Bile, bile edhe n'qitë objektin e ri atëherë s'ka qenë funksional e patën bo si spital të improvizum se numër i madh i punëtorëve që u smu.

Korab Krasniqi: E a të kujtohet qysh jonë kërkesat? Çka ka pasë diskutime ndërmjet minatorëve?

Beqir Maliqi: Drejtën me të thonë…

Korab Krasniqi: Qysh jonë përpilu kërkesat?

Beqir Maliqi: Kërkësat minatorët i kanë bo atje në minierë, veç ku i kanë qitë përjashta, i kanë qitë na i kemi pa. Domethonë, brenda në minierë kanë qarkullu qysh jonë marrë vesh. Unë po thom tonë kohën s'kom nejtë atje, kom nejtë me orë të tëra ka tri-katër orë e pesë-gjashtë orë e me natë, por edhe kom lëvizë. Kryesisht puna ime ka qenë me delegacionet që kanë ardhë këtu që e kemi najtë në zyrën e fundit atje që u tubojshim edhe për me i çu atje në vend, domethonë atje me i udhëheq edhe hyrjen edhe daljen me drejtorat që i kemi pasë kryesisht.

M'kujtohet Aziz Abrashi atëherë drejtor gjeneral i "Trepçës" që ka qenë kur i ka lutë, i ka lutë me dalë në horizontin e tetë, i ka lutë, i ka lutë, "O veç dilni se haku i familjeve, haku i fëmijëve. P'e prej dorën", e ka pasë thonë, "dorën në qoftë se ka nevojë e prej veç ju dilni e shpëtoni mos jetën e juve edhe familjet e juja". Por në asnjë mënyrë minatorët nuk kanë pranue.

Anita Susuri: A po mendon që u konë ma shumë për… që jonë frigu për minatorët apo ma shumë për situatën politike mos me u keqsu? Domethonë, që kanë kërku me dalë.

Beqir Maliqi: Po drejtën me të thonë ma së tepërmi jonë frigu për shëndetin e tyne, por fatmirësisht që nuk ka vdek. Atëherë u folke që një punëtorit i ka vdek gruaja edhe nuk ka dashtë me dalë me shku me vorros. Kështu që, shëndeti, ju kanë dhimtë gjithë ato jeta të njerëzve, sepse edhe personeli tekniko-mbikqyrës e pajshim na gjendjen. Na të knaqun kërkush s'ishte në atë drejtim, por minatorët ishin ata që e lujshin rolin kryesor për shembull edhe si trupë, si trup minatorët që kishin marrë vendime edhe ishin besatu në atë mënyrë.

Anita Susuri: E përmendët edhe familjet domethonë. A kishin ata kontakte me familjet sa jonë konë poshtë? Ose edhe ju a keni shku në shpi?

Beqir Maliqi: Jo, jo, këtu. As një natë në shpi s'kom qenë. Jo, jo, këtu, këtu. Rrallë kush që ka pasë kontakte, rrallë kush se atëherë telefona s'ka pasë. Por, për shëmbull, familjarët e mi kanë ardhë këtu, vllaznit e mi kanë ardhë te miniera, por edhe të tjerëve për shembull kanë ardhë deri te miniera, te porta jonë marrë vesh por jo, ata që kanë nejt atje në minierë ata kurrëfarë kontakti me familje nuk kanë pasë. Shumica e tyne, ata nuk kanë dalë tetë ditë e tetë netë nga miniera atje, kurrëfarë kontakti.

Anita Susuri: Mas, masi që u kry domethonë greva, ka fillu ni situatë tjetër kur kanë fillu me i lyp organizatorët…

Beqir Maliqi: Po.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu tani?

Beqir Maliqi: Ka vazhdu, atë natë natën jonë dalë…

Anita Susuri: Po.

Beqir Maliqi: Nga miniera edhe janë shpërnda {hap duart} qat' natë, pothujse, Të nesërmen kena ardh në pune {tregon me dorë djathtas}, kanë ardh edhe drejtorët, më kujtohet Burhani [Kavaja] e kemi bisedu pak për gjendjen, e sen. Masdite, qat' natë, informacioni u konë që i kanë burgos, Burhan Kavajën, e Aziz Abrashin edhe ni numër të tjerëve.

[Këtu ndërpritet intervista]

Beqir Maliqi: Kështu që atë natë përmes televizorit e murëm vesh që i kanë fillue burgosjet domethonë, kinse si organizatorë. Po kryesisht drejtorët i kanë përmend Burhan Kavajën edhe Aziz

Abrashin, Avdi Ukën, bile… po, ai ma vonë po më duket, po filluan. Kështu që, ditëve tjera drejt me thonë menihere kanë ardhë këtu milicia, e kanë rrethue, atmosferë e zymtë, a, atmosferë krejtësisht tjetër. Prej nji atmosfere kur mendun minatorët që u bo diçka e u arritën kërkesat e tyre për dorëheqje, i pranuen, u kriju nji orë policore, nji gjendje ku shiheshin njerëz të organeve të sigurimit tu u shëtit. Milicia nuk i lejshin m'u bashku njerëzit, i malltretojshin në forma të ndryshme tu i marr në pytje, "Pse ti kështu, pse knej?" Edhe në qat' mënyrë kanë fillu, tanaj, drejtën me thonë.

Mas pak kohe po më duket i kanë çu në shpi tanaj krejt, edhe kanë fillu me i thirrë nji ka nji, nji ka nji, sidomos udhëheqësave nuk na kanë thirrë neve në punë, nuk na kanë thirrë në punë më ditë të tëra. Bile mue konkretisht me thonë, kam qenë si drejtues i prodhimit, nuk ma kanë dhonë mu asnji punë, absolutikisht. Kam ardhë në zyre kam nejt aty, po nuk kom qenë i ngarkum me asnji lloj pune, me asnji lloj pune fare. Mas gjashtë mujve tani më patën, më patën heq prej prodhimit krejt më kanë pa çu me ni njësi investim dhe zhvillim, në nji ven shumë ma të ulët atje edhe ni numër si patën thirr hiç në punë. I burgosën ata të 14-tit që ishin atëherë. Mas nja ni viti të grevës drejt me thonë, këta në përvjetorin e grevës shkun në grevë prapë me 20 shkurt, në Mitrovicë kanë pasë shku dej në Mitrovicë {ngrit dorën tregon djathtas}, atëherë maheshin protesta të ndryshme, bile më duket që qat' ditë është vra ni student, ni Selman Vojvoda, që i thojmë.

Mas asajna ju kanë shkru fletëparaqitje {bën sikur shkruan} punëtorëve, dikun 1400 punëtorë, punëtorë janë dënue prej ni mujve deri në tre mujë. Mu më kujtohet mas qasaj greve une katër mujë… me disa kolegë, me Xhafer Nulin, me ni Enver Kelmendin e, kemi nejt katër mujë pa punë, pa punë, nuk na kanë thirrë në punë. Tani mas katër mujve kishe na kanë pa kthye në punë. Mirëpo, vinte t'u ra prodhimi, vinte tu u destabilizu gjendja edhe në Kosovë, kështu që dalë ngadalë edhe na largun prej pune në njifarë forme. Me 8 gusht të vitit 1990, kur kemi ardhë në punë këtu në ndërrimin e parë milicia ka qenë te porta. Ndrrimi i tretë ka dalë përjashta, ndrrimin e parë s'na kanë lejue me hy fare mrenda këtu edhe kemi ardhë nja dy-tri ditë deri te porta s'na kanë leju edhe faktikisht prej asaj kohe kemi metë na gjithë {ngrit duart lart} shiptarët pa punë.

Anita Susuri: A ju kanë thonë juve me nënshkru paraprakisht ato që e pranoni… qysh ka qenë ajo?

Beqir Maliqi: Jo, drejtën me të thonë nuk ka pasë këtu hiç. Neve na ka bllokue milicia te porta doemthonë, nuk na kanë lonë fare me hy mrenda. Kanë ardhë autobusat, të gjithë punëtorët qysh kanë ardh edhe ma herët, në portë edhe mrena porte {shpjegon me duar} na që i pajshum, plotë pinzgauera të milicisë edhe pjesa e sërbëve, mos të thom edhe boshnjakëve e të tjerëve, këta që pranojshin me punu, ata i pajshum ka shëtitën, do inzhinjera knej nëpër portë.

Do sërbë kryesisht edhe do boshnjakë i kemi pa. Neve shiptarëve s'na kanë leju në portë me hy fare. Po thom dy-tri ditë kemi ardhë deri këtu, kemi tentue {shtyn gjoksin përpara me forcë}. Osht' konë majtë ni Këshill i Punëtorëve, qato ditë ka qenë Këshilli i Punëtorëve, nalt te drejtoria ku ka qenë, u majt Këshilli Punëtorëve në njifarë forme jane besatue, "Nji për gjithë, gjithë për nji. Ose do të hyjmë të

gjithë në punë ose asnjeni". Edhe mas tri ditëve faktikisht mo as nuk kemi mujt me ardhë asniherë mo në Stantërg, jemi largu të gjithë nga puna.

Anita Susuri: Çka keni bo tani?

Beqir Maliqi: Paj çka kemi bo, shumica jo, po të gjithë jemi varë prej kësaj miniere, prej kësaj rrogës të minierës. Kush kah ka mujt, në atë kuptimin. Më kujtohet meniherë qasaj vere, solidariteti ka qenë shumë i madh a, në Malishevë kanë shkue 300 ose edhe ma shumë minatorë me vjel rrushin {ngrit gishtin tregues}. Na kanë pranue, Malisheva neve, fshatrat e Malishevës, sikur miq që thojmë na, a din çfarë pritje na kanë bo? Une s'jom konë i rregullt, po jom konë në mesin e organizatorëve me Xhafer Nulin e me do udhëheqësa, inzhinjera tjerë. Po jemi shku disa herë gjatë asaj kohe me i vizitue minatorët atje, po edhe kemi hongër darkë në ndonji odë na ka prit dikush. Po a di çfarë pritje na kanë bo të mirë? Që osht' e papërshkrushme.

E kanë punue ata nja ni muj e diçka a ma shumë, e ja u kanë pague, sado kudo ishin të mirëseardhne, sado nji vlerë {bën sikur jep të holla} e vogël, veç millin me sigurue. Masanena ka qenë, për shembull aksioni "Familja ndihmon familjen", ma vonë se rrushi kur është bo, vjelja. Mos të them ka nëntori a dhjetori i '90-tës. Ku kryesisht ana e Pejës kanë ardhë, Dukagjini për shembull, kanë ardhë e i kena bo na regjistrat, i kena bo, na inzhinjerat i kena bo regjistrat e sene, i kemi zgjidh njerëzit ma të vorfun. Edhe u lidh "Familja e mban familjen" domethonë, ata kanë ardhë prej Peje kanë thonë, "Filanin ti e kije me qekaq antarë". Ai ka kontaktue me ato {bashkon gishtat tregues} edhe masanena s'ka pasë nevoj najfarë organizimi.

Ata mes veti jonë mirrë vesh {largon dhe bashkon gishtat tregues}, veç ata dy. "Sa antarë je? Ku e ki shpinë? Sa të vyn në mujt?" Edhe ka vazhdue ai aksion. Po të mos ishte ai aksion, minatorët në atë kohë do të ishin ardhë në nji gjendje shumë të vështirë, a. Po dikun 600-700 familje jonë lidh atëherë "Familja ndihmon familjen", "Familja e ndihmon familjen". Edhe kanë shpëtue prej situatës. Edhe veç kontakti ka ardh përmes sindikatës edhe disa organizatorëve që kemë qenë edhe ka funksionue privatisht vet ata kanë… Mirëpo, ka funksionu me vite {ngrit gishtin tregues}. E mos të thom që kom miqësi të mirë edhe sot e asaj dite më njerëzit.

E masanenaj, drejtën me thonë unë, na personalisht qashtu kemi qenë të varur prej kësaj miniere se atëherë tre vllazën punojshim në "Trepçe", na largun, tjerët pa punë. Na u ka dashtë m'u marrë me punë e veprimtari krejtësisht tjetër. Drejtën me thonë jemi mirë, prej '93-tës jemi marrë me përpunimin e drurit, me cirkullara {shtyen grushtat përpara}, e me punu drunin. Fatmirësisht vllavi, arkitekti, ka qenë mjeshtër i mirë edhe na organizatorët tjerë jemi bashku edhe kemi punue me përpunimin e drurit. Kemi metë gjallë prej qasaj pune, bile kemi pasë levërdi edhe pse si lepri për zagar {lëviz dorën zig-zag}, se s'kemi pasë naj leje të regjistrum, firmë s'kemi pasë {hap duart} kurgjo. Po qashtu msheftas mrena në oborr, mrena mureve kena punue.

Leje që s'kena pasë nevoj për ndihma, po i kena ndihmu edhe të tjerët. E krijum ni situatë, ni punë bukur të vështirë, punë e ronë fizike drejt me thonë edhe e rrezikshme me ato cirkullarë e sen. Po, fatmirësisht, Zoti na ka nimu edhe e kemi punu atë punë prej '93-tës, mos të thom nashta edhe pak dej mas lufte kemi punu. Po kemi jetu mirë, punë e vështirë boll, po kemi punu me boshnjakë të Novi Pazarit, të Rozhajës për shembull. Merrshim landën e parë prej tyne atje edhe kemi punue, kemi metë… Mirëpo, gjithkush kah ka mujt. Mirëpo, kanë pa fillu, viti '91, mos të thom '90-shi, nashta jo, po '91-shi, '92-shi njerëzit kanë nis me dalë jashtë me ikë prej këtuhit.

Njerëzit… numër i madh i minatorëve i ka rrokë fëminë me hup. Shumë më kujtohet ni Maliq Ahmeti, nifarë lloderisti këtu ka qenë {tregon me gisht mbrapa} e takova, fundi i '91-shit, punëtor e kom pasë disa vite këtu, më tha, "A ke nije diçka?" Thashë, "Jo", tha, "Po du me hup". I ka pasë gjashtë-shtatë djem ai, i ka pasë diku nonë antarë apo dhetë. Thashë, "Ku bre Maliq?" Ja nisi po qanë. Tha, "Po e marrë krejt fëminë edhe në Suedi po du me shku me hup" tha. Po jo vetëm ai, po edhe shumë të tjerë mos të thom nja 500-600 familje, '91, '92, '93, në qat' kohë kanë shku përjashta se s'kishin qysh me mujt me ekzistue.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Qysh ju ka... luftën qysh e keni pritë, qysh ju ka gjet lufta?

Beqir Maliqi: Po lufta drejtën me thonë na ka gjetë të gjithëve neve familjen këtu në Kosovë, se na punojshim me qat' punë edhe mbetshim gjallë edhe mendojshim që do të kalojë kjo situatë një ditë e do t'i kthehemi jetës, e do të… veç që ish qëllimi qysh me tejkalue, me mbijetue edhe kemi qenë gjithë këtu në Kosovë. Nga viti '80 nuk jetojmë mo në këtë fshatin Kutllovc, po jetojmë te Vushtrria atje, nji fshat Dobërlluk thirrët atje, aty doemthonë jetojmë. E na ka nxonë të gjithëve këtu, drejtën me të thonë, na atëhere… filloi lufta në Shalë ko, shumë mirë më kujtohet ditën e parë që ka fillue lufta, na vllaznit ishim atje, gjashtë vllaznit sen, jo mo s'ka çka me prit, domethonë u kriju atmosfera me shkue.

Unë me vllaun e katërt që e kemi edhe une, kemi shku prej Dobërlluki kemi ardhë, nuk kemi guxu me ardhë në Tunelin e Parë se kish aty milicë, po në fshatin Rekë kemi hyp përpjetë malit për me shku, atje kemi shku në fshat tonin atje ku ishte shtabi. Ishin formu ato edhe bojshin roje se ish ni pikë e ushtrisë jugosllave në fshatin tonë atje, Maja e madhe i thojnë, aty osht' e vendosne ajo bile pi mas Luftës Dytë Botnore, mos të thom edhe para, është ni pikë strategjike aty ku ka pasë permanent ushtarë. Si fëmi kur kom qenë, domethonë kur i kemi ru delet atje, kanë qenë ushtria aty verë-dimën atje kanë nejt e kanë pasë ni bazë ushtarake {spjegon me duar} në maje. Nivel i naltë osht' aty, krejt Kosova shihet prej asaj pike edhe Prishtinën e shohim.

E shkum atje në Kutllovc, tham, “Valla na jem qishtu të Kutllovcit” ni komandant, ni Feriz Kapetani bile i thojnë, ish konë. Jena ardhë qishtu, “Na jena të Kutllovcit, po dojmë me u inkuadrue këtu”. Kemi nejt gjithë ditën aty më kujtohet, bile ka qenë shtëpia e nji komandantit që ka qenë në Shalë, ni Hysni Ahmeti, e ni Hilmi Ahmeti që ka qenë aty në shpi tyne ka qenë i vendosun shtabi. Po qai komandanti që ish aty ma kryesori tha, “Vallahi” tha, “këtu po kemi ushtarë e armatim s’kemi” tha, “neve” tha, “po na vyjnë” tha, “ndihma,” tha, “me pasë mujt ju me shkue ndihma”. Fshati jonë drejt me thonë u konë ni fshat që mirren me bujqësi edhe bukur të pasun ka pasë njerëz. “Jo, ajo s’o problem” edhe shkum, mramje shkum atje e organizum fshatin aty drejt me thonë. E tubum patate, dhanë pare, e mushëm ni traktor, me traktor tonin i kena çu atje në shtab, në Kutllovc, në fshat timin atje i kena çu qato ndihma.

Po, lufta vazhdojke edhe ma tutje. U konë bo ajo ofenziva ‘98-tën diku e shtatorit, në Shalë atje ku krejt domethonë {tregon me dorë lart majtas} këmbësoria kanë hy, ushtria, kanë vra ni numër të njerëzve këtu edhe në Melenicë. Mirëpo, i çvendosën prej, prej Shale të gjithë momentalisht. Masanenaj, u kthye kadal-dale edhe ‘99-tën na kanë nxon në Dobërlluk atje, në Dobërlluk janë hi me 16 prill diku, me 16 prill e kanë çvendosë fshatin Dobërlluk atje. Ne që ishim kryesisht pjesë e Shalës, shkumë me ta që i nisën për Shipni. Po na u çvendosëm në nji fshat aty afër burgut Smrekonicës, bile fshati Smrekonicë thirrët, e kishim dhondrrin aty e shkum. Po edhe ni numër i madh i njerëzve nuk shkun për Shipni, po shkun u vendosën nëpër do fshatna kishe që ishin ma të qeta asajde edhe kështu.

Drejtën me thonë, tanaj ka… në prill kur ka qenë ajo ofenziva, une s’disha ça me bo se ishum kallabllak. E kum pa marrë ni djalë të vllaut, u konë ka 20 vjeçar edhe kom pa dalë në Shalë veç mos të qëllojmë bashkë aty të gjithëve përmeniherë. Thojsha, nashta bile dikush me mujt me shpëtue. Nuk u dike qysh po shkon. Edhe jemi dalë në fshatin… në Bajgorë ko te ni i afërm pak kemë pasë bujt. Më kujtohet qato ditë unë u nisa me shku në shtab, atje ma nalt, ni mahallë ma nalt shtabi. T’u shku rrugës te shkolla e Bajgorës jom konë me qat’ djalin e vllaut edhe ni nip të nipit që isha te ai t’u nejt aty rrugës edhe kah shkojmë, aty kodër edhe shkolla, {shpjegon me duar} kur ka dalë ni aeroplan. Në shpejtësi *vuuup* (onomatope), veç ju kom thonë këtyne, “Bini!” Jom ra {vendos duart mbrapa kokës} jom mbrojt si në ushtri që na msojshin tyne herë me mbrojt kokën.

Vuuup (onomatope) e ka lëshu bombën, bomba ka lëshu, kasetë bombe, 30 metra bombën e fundit që e kem pasë. Domethonë, prej mas shkolle, shkollën e ka rrok para shkolle edhe ka vazhdue aeroplani {shpjegon me dorë}. Shkum na te shkolla dulën do farë femrash, bile ishin konë banorët e Tunelit të Parë, kah ishin sillë e në shkollë të Bajgorës aty… s’di nja tre-katër vetë qaty i kanë pasë myt. Ni Adem Trepça më kujtohet, ni Ismet Haliti e kanë pasë plagosë, dej atje {ngrit dorën tregon para vetes} ni tjetër fshat ku ka pasë mjek, atje ka pasë vdekë. Ni çikë edhe ni Adem, s’di qysh veç qat’ ditë kanë pasë ndodhë domethonë atje. Na shkum në shtab, drejtën me thonë dojsha me marrë naj ndihmë se ju bona ngarkesë atina që shkova. Kur shkova atje tha, “Valla ka 400 kilogram, kësi gram miell” thashë, “Jo valla për qaq mos më jep hiç”. Dojsha me ja çu, me ja rezervu a di, naj thes a diçka.

Mirëpo, nuk zgjati shumë edhe, edhe ofenziva aty hinën prapë në Shalë atje edhe i çvendosën krejt prej Shale, na u zhdergjëm [zbritëm] poshtë atje. Ka qenë ajo nata e 2, e 2 majit '99-tës. Kur domethonë, u hi ofenziva në krejt Shalën, i kanë pastrue edhe ka ndodhë masakra e Studimës. Na kemi qenë… nuk e kemi ditë çka po ndodhë në Studime, na kemi qenë në Smrekonicë te dhondrri, po, na kanë ardhë ushtria e policia, na kanë qit prej fshatit Smrekonicë. Na kemi qenë familja… pos dy vllazni kanë qenë te shtëpiat atje në Dobërlluk, na të tjerët kemi qenë në Smrekonicë aty. Edhe na kanë qit prej shtëpive, na kanë tubu në fund të fshatit Smrekonicë atu, edhe na shumë jena konë kallabllak 26-27 antarë drejt me thonë edhe u shkepëm edhe hupëm mes veti sepse kallabllak i madh.

E babai ndjesë pastë, kishte qenë me vllaun e madh, i kish pas thonë, "Nuk rri une në këtë kallabllak" ia ka msy te shpia atje me shku në Dobërlluk edhe e ka ditë që ata dy djemtë i ka atje, me ju kallxue që bajagi qe qishtu po ndodhë. Edhe kur ka ardhë te shkolla Dobërllukës, osht' atu ni shkollë në oborr të shkollës e kishin pasë vra. Osht' afër aty rruga për Prishtinë që shkon, prej rrugës për Prishtinë e kanë gjue në oborr të shkollës. Zaher i kanë thonë, "Nalu!" Ai s'u nal, a din se u konë pak si. Aty e kishin pasë vra, na s'kena ditë. Neve na kanë tubu te burgu atë nate, na kanë tubue krejt fshatin mos të thom nja dhetë-nizetë mijë banorë, se nuk u konë veç fshati po edhe fshatrat përreth ato që kanë ardhë. Po nja dhetë mijë banorë me siguri kanë qenë, se ni livadh bukur i madh nuk i zike. Edhe u konë në anën tjetër thojshin që na momentalisht s'i pajshëm do të këqij që i kishin tubue.

Edhe kanë hy aty… ishte hala pasditja, kanë hy milicia edhe ja kanë nis {sikur numëron me gisht} m i da të rijtë. Veç i thojke, "Ti, ti, ti" i shtishin meniherë në burg atu "Ti, ti, ti, ti". Bile drejt me thonë unë atëherë ka 45 vjet nuk u rujsha hiç, do të ri i mshefshin {tregon poshtë tavolinës}, i rujshin për mos me i shti në burg. Une s'u rujsha, menojsha që, thojsha që nëse më thotë, thom, "Jo more unë jom i vjetër, i kom 50 vjet e kusur". A s'ishte puna ashtu, kanë marrë të moshave të ndryshme, kanë marrë edhe pleq, se të nesërmen e kom pa që i kishin torturue {prek fytyrën} të përgjakun e që i kanë rreh. Mirëpo, na atu s'e kena ditë që babën na e kanë myt. Na kanë tubu atë natë, po natën e morëm vesh që ka ndodh edhe masakra e Studimes, se prej asaj ane janë ardhë njerëzit. Mirëpo, prujshin me kamiona prej Studimje, i shtishin në burg. Deri në mëngjes atu kena nejt.

Anita Susuri: Veç burrat a?

Beqir Maliqi: Jo, jo, gra e fëmijë e, bashkarisht krejt jonë konë. Jo, jo, jo krejt bashkarisht jonë konë. Të nesërmen kah në ora 12, ç'a i kanë marrë ni numër të madh i murën e i çun atje në burg. Ç'a metëm aty, kanë thonë, "Merrni pajisjet, traktora e ç'a kini e m'u nis për Shipni. Jena shku na në Smrekonicë atje kena marrë, kena pasë traktor e kamion e… Bile, ata vllaznia që metën te shpia… qaty qat' natë sa kem u shkep lajmi që njonin vlla temin e kanë vra, a s'ish konë ashtu, e kishin pasë gjujt aty te ura, se e kanë vra edhe njo, në Novosellë, Maxhuni njo, mbiemrin, e kishin pasë vra. Vllau i jemi ish konë arrit me hi me ni shpi' aty afër edhe gjithë natën, tha, "Në gjys natës jom dalë, jom ikë prej atuhit". Kishte dalë anej përtej Sitnice, kish dalë në fshatra tjera. Edhe i kena marrë taj, kamion e traktor e jena mush

në traktora e… edhe banorët tjerë që s'kishin transport në kamion tonin e në transport edhe për Shipni jena nis.

Kena bujt ni natë te Klina dikun atje, të nesërmen prapë jena nis, dej jena shku në Kukës. Në Kukës janë shpërnda tanaj. Masi jena hi në kufi, u mërzitëm a di, se prej ni torture, drejtë me thonë, e malltretimeve, rrahjeve që t'i bojshin në rrugë. Se plaçkë, para se me hi në doganë plaçkë {zgjat dorën sikur jep para}, kamionin s'na ka lonë me hi, tha, "500 marka", ose na hiçi prej reni kamionin, u dufke m'i bo paret me ja dhonë. Më kujtohet mirë e kom pasë ni unazë të arit këtu {prekë dhe shikon gishtin}, "Ama, ama" une s'mujsha me nxjerr {bën sikur don ta heq unazën prej gishti}. Dojke me ma pre gishtin, gati ma ka pre gishtin, i pata do marka {vendos dorën afër xhepi} ja kom pasë dhonë 50 marka, a s'di sa. Në shpejtësi se ishim para dogane aty në Kukës.

Anita Susuri: Serbët a po?

Beqir Maliqi: Si kemi… po, serbët. Si kemi hi mrena në kufi ja nisëm ma… ishte nji ndjesi, a, ish e vështirë, nifarë emocioni, kur dojke shpirtin… para gjys ore dojke me më myt në atë anën, e në këtë anë, "O vlla", të pritke knej, të dhoshin… Edhe më kujtohet më plasi nifarë vaji a, edhe po i thom vllaut të madh, thash, "Hupëm krejt a", a din? Tha, "Jo shuj, a di çka u bo. Babën" tha, "e kanë vra", "Ku?" tha, "Natën e kanë vra aty te shkolla.

Korab Krasniqi: S'të ka kallxu vllau deri keni mrri në kufi, a qysh?

Beqir Maliqi: Meniherë si jom hi në kufi une kom ni.

Korab Krasniqi: Ai tanë kohën e ka ditë?

Beqir Maliqi: Ai e kish pasë ditë e s'më ka kallxu mu. Se i kishin pasë kallxu…

Anita Susuri: E qysh e ka ditë ai?

Beqir Maliqi: E ka ditë se kishin qarkullu natën njerëz asajde {e lëviz gishtin tregues} në komë. E nji, i thojmë njo i fshatit aty, prej nji fshati Mazhiq që banon aty në Dobërlluk e kish thonë, "Vallai qishtu, qishtu, kur kom kapërcy asajde babën ja u kanë vra te shkolla qaty e kom pa". Natën, qat' natë na sa jena konë te burgu të tubum.

Korab Krasniqi: E me trupin e babës ç'a ka ndodh?

Beqir Maliqi: E me trupin e babës, taj edhe ata vllaznia këtu që kanë metë… se na shkum për Shipni, ata dy vllaznia e kishin pa marrë vesh atë natë që u vra baba. Po nesërmen masdite ishin shkue me lyp te vorret bile, se kallxon ai vllau. E masanej e kanë vorros e shkue. Nin që te shkolla po gjatë ditës e

kishin marrë “Përparimi” i Vushtrrisë, punëtorët e “Përparimit” bile romët, magjuptë që kanë punue ishin pasë shku aty babën tonë e kishin pa marrë edhe Shefqet Maxhunin te ura që e kishin vra. I kishin ngarkue edhe i kishin hjek prej atyhit. Tek ma vonë përmes qatyne magjupëve, ç’a kanë nejt këtu në Kosovë e kishin pa marrë babën edhe ato e kishin vorros në vorrezat e Nadakovcit, në vorrezat e Nadakovcit, jo në Dobërlluk po në vorreza të Nadakovcit. Kështu që, kur jemi kthye na prej Shipnie mas krejt atyne… rrugës ka vijmë jemi nalë aty edhe e kemi gjet, e kena gjet {sikur ngul diçka me dy grushta} i kishin pa ngul shtagat “R.M.” Rexhep Maliqi atu.

Korab Krasniqi: Po kthena në Shipni, qysh, qysh u konë, qysh keni kapërcy në Shipni, ku jeni konë?

Beqir Maliqi: Jena konë në Kukës drejtën me të thonë, kena nejt nja ni muj në Kukës. Na ishum kallabllak që po thom në familje. Dy-tri netë s’jena vendos kërkun atu, bile thojshin nifarë u konë, nifarë kampi i arabve thojshin janë kushtet ma të mira, ata s’e pranojshin kërkon. Në tretën ditë jena vendos “Mjekët pa kufi” janë konë qatje në Gostil, u thirrke nifarë fshati, e jena vendos në nji shatorr si ma i madh {hap duart} që ka qenë, po prapë s’na nxejke neve tonve. Po e kishum kamionin nja pesë-gjashtë vetë, në kamion flejshum, se u konë i mbulum {shpjegon me duar} kamioni kështu. Në kamion, tjerët aty në atë shatorrin.

Po kushtet shumë të vështira kanë qenë, kurrfarë ushqimi që ka ardhë në Kukës, po thom në kamion bukët e mykta. Si tullat kur i gjun ashtu, as mbulojë kamioni, qashtu {bën sikur hedh diçka} në atë dyshemenë. I kishum do pare kena ble ushqim, drejtën me të thonë, asajde nëpër Kukës, se përndryshe marojshum uni a. Na drejt me thonë si familje e madhe ka shkojshim me traktor, nji mijë kilogram miell me veti i kena pasë. Se menojshim po na nalin në rrugë, a në Drenicë, a dikun e ç’a me hongër ata njerëz? E kështu që nji mijë kilogram i kena pasë qit mill në Shipni atje në atë anë. Bile, bile, më kujtohet ja pata shit se na met traktori larg s’mujke rreth shatorrave, na pat… ni, ni bukëpjekësi ja kemi shit 700 kilogram përniherë miell. A di, veç mos m’u prish në diell aty me nejt.

Korab Krasniqi: Sa kohë keni nejt?

Beqir Maliqi: Ni muj kena nejt në Kukës, masanej jena zhdirgj jena shkue në Milot, në Milot. Te ura Milotit aty u konë nifarë fushe, diku 70-80 shatora. Bile une kom qenë nifarë udhëheqësi i nifarë sektori C, u konë A-ja, B-ja, C-ja. Po mas tri jave pothujse, u arrit marrëveshja, bile kish shatorra të pambushun ende, të zbrazët, se t’u prit, u ndërpre mo. Nuk ndërtojshin shatorra se u hap lajmi që u arrit marrëveshja, atje i kemi pasë kushtet pak ma të mira drejt me të thonë. Gjithësecili tani e ka pasë, familjet u ndanë, se ishim të martum, pesë-gjashtë shatora ma të vogël i murëm. Na e dhoshin nifarë ushqimi, buka ma e mirë, e pregaditshin vet familjarët kështu. Po, jeta pak ma e mirë, atu buzë ni lumit asajde, kushtet pak ma të mira i kemi pasë, po në shatorra.

Korab Krasniqi: E qysh e keni përjetu lajmin që këmbësoria, NATO veç u fut në Kosovë edhe tash po shlirohet vendi…

Beqir Maliqi: Paj, drejtën me thonë e përjetum, po vujshim prej aspektit qysh s'qëllum atje. Domethonë, se kemi përjetu me konë në Kosovë po jashtë Kosove. Edhe tentojshim me çdo kusht m'u nisë mejherë edhe pse s'na lejojshin ata. Ajo kur ka qenë 12 a 13, kur e kemi marrë vesh. Tek me 24, 24 qeshor na jemi nisë, 23-24, për me ardhë knenaj. Kemi bujt ni natë në Kukës. Taj prej Kukësit, m'doket me 25 qeshor kemi mrri në… te shtëpitë ko.

Korab Krasniqi: Qysh e keni gjetë shpinë?

Beqir Maliqi: Drejtën me thonë, nuk i kanë kallë shtëpitë atu në fshatin Dobërlluk, nuk i kanë kallë. I kem pasë do dajë afër atu ishin përkujdes, se kemi pasë lopë e ishin përkujdes, e kena gjetë ni dajë ish konë aty tu e ru shpinë e tu nejt e… Po çka m'u kthye, çka m'u kthye oborri për qaq kohë ishte mush bari edhe pse ka qenë i shtrum me zall e sene. Krejt bari ish rrit dej në gu. Mjerim, mjerim! Krejt tjetër botë, tjetër…

Korab Krasniqi: E babën a e latë… babën?

Beqir Maliqi: E ka kthehum prej Shipnije, ka shkojmë, jena nalë në vorre të Nadakovcit. Edhe në vorre të Nadakovcit atu e gjetëm shtagën "R. Maliqi" edhe "Sh. Maxhuni", ni Shefqet Maxhuni, djalë 20 vjeçar që e kanë pa myt, afër babës tonë qaty nja 50 metra distancë {hap duart}. Edhe erdhum na, dojshim me rivorrosë drejtë me thonë babën. Pytshim njerëz, pytshim… atu ishin konë 36 varreza të reja afër baba ku ishte, domethonë krejt gjatë luftës që i kanë myt, prej, prej fshatrave të ndryshëm, jo veç të rrethit atu po edhe tjetërkah. Po edhe hoxhallartë, "Jo bre e ka pasë fatin me qata s'keni pse…" në tokë të Zotit në atë kuptimin, e sene. E çelëm të pamen edhe nuk e rivorrosëm.

Tu e majt të pamen erdh ni njeri i panjohur edhe po prezentohet. Ishte baba i Shefqet Maxhunit, atij djalit të Novosellës, na i thojmë atje. Edhe po tregon ai, thotë, "Qishtu, qishtu, qishtu, qishtu, e kom çelë" thotë, "vorrin une atje edhe kom shku ku ka shkrue ajo shtaga, në dërrasë atu 'Shefqet Maxhuni' e kom çelë për me nxjerr djalin tem, po më ka dalë ni plak", thotë. Ja u kanë ndërrue vorret, "E qysh kom ni për juve ai baba juj" thotë, "osht'". Ata shumë afër vorrin po, ven se me ja ngjit atë shtagën babës tonë, ja kanë ngjit atij djalit, ja u ka ndrrue. Edhe neve na hini tani ajo në krye, "A masi qishtu ka ndodh…". Të nesërmen shumë herët, se ish vera, qershori domethonë, ka fundi qershorit jena shkue e kena rivorrosë babën. E kena çplue atu, e kena hap vorrin ko në Dobërlluk, e kena marrë, e kena…

Korab Krasniqi: A e njoftët?

Beqir Maliqi: Po, interesant ishin konë ato vorreza si lagështi, dul uji diqysh si fllad, zaher, asi... Me rroba qysh ka qenë, qashtu në njifarë forme, e ka pasë nifarë mantilli {bën sikur veshet}, komplet kështu e kena marrë. Domethonë, i ka ra mas dy mujve me rivarros babën edhe me pru në Dobërlluk, e kena marrë, e kena nxjerr, e kena qit {shpjegon me duar} në kamion, e kena pru, e kena hap vorrin në

Dobërlluk edhe e kena rivorros ngat nonës tonë, se nona ma herët na pat dekë '93-shin edhe e kena rivorros.

Anita Susuri: Domethonë, ka qenë qysh ka thonë ai plaku…

Beqir Maliqi: Qysh ka thonë, domethonë atij djali i ka dalë në emën të babës tonë atu ku ka shkrujt edhe i kishin pasë ndrrue ato, afër ato ven se me ja u ngjitë, ja u kanë ngjitë të kundërtën. Po të mos ishte ai na gjithë kishim menu që qai vorri ka qenë. Po kur e ditëm që u hallakat vorri edhe e ka vlerësu ai që nji plak, jena shku qaty ku na tha ai edhe faktikisht na dul baba jonë. Edhe e rivarrosëm në varreza tona aty afër nonës, se e kemi pasë nonën e kemi varros atu.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Thatë që vllaznit ju kanë metë këtu, i kanë shti në burg në Mitrovicë…

Beqir Maliqi: Po.

Anita Susuri: Pastaj ata janë liru mas luftës, jeni bashku krejt apo qysh?

Beqir Maliqi: Jo, në kohën kur thash kemi shku për Kukës, domethonë edhe kemi qëndru gati 1 muj, tri javë, mas tri javë ja kanë nisë prej burgun Smrekonicës me ardhë grupet e para me autobusë që i kanë burgos ato. Edhe grupi parë kur ka ardhë, kanë ardhë disa të njofshëm edhe na kanë tregue që ata dy vllaznia që kanë metë në Kosovë i kanë marrë në burg. E më pastaj pas tretës ditë ka grupet e fundit që jonë ardhë, erdhën edhe ata vllaznia. Tani kur u bonëm bashkë krejt familja atëherë kemi shku në Milot atje edhe kemi nejt edhe tri javë ditë edhe pas arritjes marrveshjes jemi kthye komplet në Kosovë.

Anita Susuri: Thatë kur jeni kthy shpinë qysh e keni gjet, keni fillu ka pak me u sistemu në shpi. Po pastaj me punë qysh ja keni bo, a jeni kthy meniherë në "Trepçë"? Qysh, qysh ka qenë kjo?

Beqir Maliqi: Jo, na kur kemi ardhë drejt me të thonë meniherë atu, shpija nuk ka qenë e demolume, nuk ka qenë e djegun, jemi vendosë, jemi vendosë. E kemi kry të pamën e babës edhe kemi fillue… se ish lufta me punue, pothujse kemi nisë meniherë me gjallnue, me veprimtarinë që e kemi pasë, që e kemi pasë domethonë me përpunimin e drurit që jemi mirr. Kemi punu qasaj vere qashtu. Kohë pas kohe, une kom kontaktu me kolegë e me sindikatën e Stantërgut, po drejt me thonë, meniherë mas lufte nuk na kanë leju neve këtu me ardhë edhe pse ka pasë tentime me ardhë në "Trepçe".

Po diku na jemi ardhë ditën e parë këtu në punë ka 22 dhjetori i '90-tës, i '99-tës. 22 dhjetori kemi ardhë edhe kemi hy këtu në minierë me ni kryetar i Mitrovicës, nifarë Demi Stura u konë, thojshin osht' njeri i krizave. U konë si kryetar i përkohshëm i Mitrovicës, që thojshin veç nja dy javë ka nejt. Po, ai në njifarë

forme e ka çelë rrugën për me ardhë na këtu, edhe kemi hi qitu {tregon me gisht majtas} në restoranin e tonë këtu të minierës që e kemi. Edhe e ka majt ni tubim, këtu me numër të madh të punëtorëve. Bile, bile pat thonë, "Une ja u kom çelë ni dritare për me hy, ju duhet me çelë derën me hy". Edhe qat' dite po më duket kemi hy në minierë, kemi hy në tesha civile kështu veç me pa gjendjen deri në horizont të nimdhetë edhe jemi dalë.

Të nesërmen jemi ardhë me grupe edhe ekspertë tonë, edhe e kemi lëshue, e kemi lëshue sistemin e pompimit të ujit. Sepse këtu e gjetëm ni gjendje ku ni sasi e madhe e ujit përmi nji milion metër kub ujë të akumulume, domethonë e kemi trashëgue gjendjen. Që atje në horizontin e poshtëm, në horizontin e nimdhetë është ni derë e ujit që kishte qenë e mbyllun edhe pothujse deri {ngrit dorën lart} ngat horizontit dhetë kishte hy uji, ku llogaritej mbi nji milion metër kub ujë. E kemi lëshue sistemin e pompimit edhe menihere kanë fillu pompat me punue. Nga ajo ditë taj drejtë me thonë e kemi bo nifarë mbikëqyrje të minierës edhe pse dyshojshum se mos kanë lonë ndonji ekspllozіv, ndonji bombë, ndonji diçka, po nuk ka pasë ni diçka të tillë.

E pamë që osht' shfrytëzue pamëshirshëm miniera dhetë vite, duke mos i respektu rregullat edhe ligjet e xehëtarisë. Po e kanë ditë që kanë me lëshu niherë minierën veç kanë grabitë. Trupat ma të pasun që kanë qenë i kanë shfrytëzue, po pa i respektu rregullat e xehëtarisë edhe pa e respektu sistemin e shfrytëzimit që osht' në minierën tonë. Kështu që, na prej asaj dite domethonë e kemi fillu me pompa nxjerrjen e ujit po ishte sasi e madhe e grumbullume e ujit, po edhe gypat ishin mbyll me gëlqerore nuk mundte sasi e madhe e ujit me u zbrit niveli. Kështu që, na e përcillshim çdo ditë nivelin. Erdh mas pak kohe situata që me na dalë uji në horizontin e dhetë. Po të del uji në horizontin e dhetë edhe shkon përmes pusores do ta fundoste horizontin e nimdhetë edhe do të mbyllej miniera.

Drejtën me thonë, na aso kohe i njoftojshim institucionet, po s'kish institucione, ka qenë qeveria e përkohshme. Shkojshum te disa njerëz me i njoftu me gjendjen kryesisht drejtori që ishte atëherë Burhani [Kavaja]. Po nuk ishin të njoftum, nuk kishte mundësi, nuk kishte organizim, ne me trup e me shpirt mundoheshim ta shpëtojmë minierën, sepse e dishim randësinë e kësaj miniere. Ka pa ardhë situata, drejtën me thonë, me na fundos miniera po të mos e vendosshim na në horizontin e dhetë ni barikadë {shpjegon me duar} të betonit edhe me mbyll fizikisht horzontin mos me shku ujët nëpër pusore me naj fundos pompat, miniera sot e asaj dite do të ishte e fundosun.

Po fatmirësisht na e vendosëm ni barikadë betoni atje edhe dul uji në horizontin e dhetë, po u akumulu në horizontin e dhetë edhe në njifarë forme shpëtoi miniera. Ma vonë tani dej kena marrë hapa me bo pastrimin e gypave me acid klorhidrik, patëm arrit deri dikun me, me, me zbrit nivelin. Po kanë shkue disa vite. Na kryesisht nivelin dej në vitin 2005 nuk kena mujt me çelë qat' derën e ujit që po thom, që ka qenë uji i akumulum mrapa derës. Në vitin 2005 e kemi çelë, në vitin 2005 tani ka fillu prodhimi provues, fillestar qysh me thonë. Bile me 20 gusht 2005-tës e kemi fillue prodhimin edhe prej atëherë domethonë çdo here kemi ardhë duke e rrit prodhimin, domethonë në njifarë forme, prej viti në vit.

Posaqërisht drejt me thonë në kohën, në kohën kur kom qenë une drejtor 2008-2014, ka qenë prodhimi ma i madh mas lufte në qat' kohë. Kemi qenë ni ekipë e e kolegëve këtu inxhinjerë që dojshim edhe nifarë forme na zanat e kemi qet farë pune edhe jemi konë të përkushtum rreth miniere edhe para lufte e kemi njoft, po posaqërisht mas lufte që mendojshim me çdo kusht qysh me fillu prodhimin. Po edhe nuk na lejshin, më kujtohet ka qenë ni epror atëherë i, i nivelit të Kosovës i thojshim, "A po ja nisim prodhimit?" Thojke, "Çka po të vyn" thojke, "prodhimi? Veç bohet problem politik me qit prodhim". A na menojshim në atë fillim që ja nisum, meniehrë me lëshu prodhimin, me prodhue, sepse kështu objektet kapitale kanë qenë në rregull përpos sasia e ujit që ka qenë e akumulume atje.

Nuk ka qenë i demolum kundrejt çfarë periudhe kemi kalue luftën as pusi kryesor, as stacioni i kompresorëve, as ventilatori, nuk kanë qenë të prishta, nuk kanë qenë të dëmtume. Kryesisht miniera asht' damtue me metodën e shfrytëzimit edhe vjedhjen e xehes që e kanë bo sërbët pa i respektu rregullat. Domethonë, dëmtimi i madh i minierës në qat' drejtim ju ka bo. Mirëpo, nuk ishin të interesum kërkush, tek arritëm në 200-tën me bo prodhimin. Bile, bile, kur i shkrujshum raportet, i dhojshum, nuk guxojshum me thonë që po prodhojmë, po në fazën e përgaditjeve të minierës i kemi prodhu edhe qekaq xehe, kishe tu e bo përgaditjen. A na faktikisht e nxirrshim xehen kështu, po tretmanin qasi soji e kemi pas veç në fazën e përgaditjes jo në fazën e prodhimit. Diku 2005-tën na e kena marrë ni licencë për hulumtime, thojke, jo për prodhim po për hulumtim. Në firmën e qasaj për hulumtime na e nxirrshum edhe ni sasi të xehes sa me mujt me mbijetue.

Anita Susuri: E pse deri në dhjetor nuk jeni kthy, po më doket ka pasë probleme me krijimin e bordit të drejtorëve diçka? Prej shlirimit domethonë deri…

Beqir Maliqi: Po drejtën me thonë, kanë folë atëhere, është folë për bordet, nuk kemi qenë atëherë, thuhej që është caktu ni bord prej qeverisë nashta të përkohshme atje që na s'kemi marrë pjesë, po nifarë forme na i kishum strukturat, kur na kanë largu prej pune edhe qashtu edhe e kemi fillue. Domethonë, e kemi fillu me Burhan Kavajën, me Aziz Abrashin, me tjerët kolegë, Mensur Fejzën e këta tjerët kolegë. Une, Xhafer Peci, Qazim Jashari, Muhamed Abazi do që kemë qenë do kolegë, Zejnullah Azemi që kemi qenë për shembull edhe kemi fillue. Na minierën e kemi ditë, drejtë me thonë, çdo skutë, çdo… të minierës e kemi ditë, e në qat' drejtim e kemi fillue punën.

Anita Susuri: Tash ju jeni zëvendës drejtor.

Beqir Maliqi: Po, momentalisht, kom qenë drejtor prej vitit 2008 dej në 2014, 2014-tën, osht' bo ndrrimi. Momentalisht osht' Xhafer Peci drejtor i minierës, ni kolegë i imi.

Anita Susuri: Qysh po ju shkojnë sot punët?

Beqir Maliqi: Paj drejtën me të thonë, i kom përjetu të gjitha fazat rreth "Trepçe". Kom mendu mas lufte qysh ja dimë randësinë "Trepçës" e pasuninë që na e ka çue Zoti këtu, kom mendu që i madh e i vogël në Kosovë do të çohen, e do të kqyrin me e rikëmbë, me e ngritë. Nuk ka ndodhë ashtu, në atë drejtim jemi të pakënaqur të gjithë, jam edhe une personalisht, sepse nuk ka ndodhë nji angazhim rreth "Trepçe". Nashta na këtu si personel mbikëqyrës i "Trepçës" nuk e kemi ditë politikën mrapa ç'a po zhvillohet, qysh qëndron çashtja politike e Trepçës. Ne e kemi pa teknikisht që ka pasë mundësi edhe e dimë çfarë pasurie osht' këtu në minierë, po jo, nuk ka pasë angazhim në njifarë forme qeveritë që jonë ndrrue veç sa me majt gjallë "Trepçën".

Çdo herë kanë dhonë kapak, kaj infuzion, do subvencione në fillim të vitit jepen. Prej 2005-tës janë dhonë për përgditjen e minierës, po deri tash mbi niqind milion në "Trepçe" jonë hy, domethonë, për përgaditjen e "Trepçës" subvencione. Por, shpeshherë na nuk kena mujt me mbulu me prodhimin që e prodhojmë, kështu që kemi marrë edhe të ardhuna personale edhe nga subvencionet e qeverisë. Po nuk ka pasë interesim drejtë me thonë, na gjithmonë jemi tut çka po ndodh me "Trepçën", jemi konë kundër privatizimit të "Trepçës", çka di une… Po prej vitit 2000 e sa tash, 2015 po, osht' aprovu ni ligj për "Trepçën", ku "Trepça" 80 për qind e aksioneve i ka qeveria në "Trepçë", 20 për qind thojnë punëtorët. Po edhe mbas kësaj nuk ka najfarë interesimi, nuk ka absolutikisht najfarë interesimi. Na po punojmë e po prodhojmë.

Por, sidomos kjo koha e fundit që pandemia na ka goditë, se kanë ra çmimet shumë. Najfarë prodhimi i madh nuk po munët me u bo sepse nuk ka as pajisje, pajisjet janë të vjetërume. Fuqia punëtore është mplakur, drejtë me thonë unë kur kom qenë drejtor është marrë gjenerata e parë, është marrë gjenerata e parë e punëtorëve të ri. Atëherë ka qenë drejtor gjeneral me thonë në nivel "Trepçe" ni Ferat Shala, që osht' angazhue rreth "Trepçës" edhe ka bashkëpunue edhe me të tjerët kolegë me neve në minierë të Stantërgut po edhe në minierën e Artanës atje. Kështu që, u arrit atëherë për herë të parë mas lufte me marrë ni gjenerat, janë marrë 150 punëtorë. Po të mos ishin marrë qajo gjeneratë e punëtorëve edhe m'u trajnue, m'u edukue në frymën e minierës edhe në profesionet e minierës, miniera do të mbyllej {bën sikur mbyll me çelës}.

Por, fatmirësisht u murrën ata e kem pa bo ni trajnim të puëntorëve për herë të parë në histori të minierës së Stantërgut. Me ju majt mësim teorik edhe praktik atje në minierë e m'i trajnue për kushte të minierës. Po edhe osht' konë nifarë marrveshje me Ministrinë për Punë Sociale, u bo ndrrimi i punëtorëve të vjetër me fëmitë e tyne. Domethonë kush ka dashtë me dalë në pension të parakohshëm, ka pasë mundësi që diku rreth 56 veta po më doket janë ndrrue, e u arrit mbi 200 punëtorë të ri. Kështu që, momentalisht janë qata tu e majt prodhimin në "Trepçë". Janë edhe ni numër i të vjetërve ende, po drejtën me të thonë, fatkeqësisht nuk u bo për gjeneratën e vjetër. Ne e fillum punën, thashë ka qenë ajo marrveshja "Nji për gjithë, gjithë për nji" mas lufte nuk patën mundësi…

Kur pritëm na që u bo mirë, edhe pse e dhamë shëndetin e rrezikum e… kur pritëm që duhet m'u bo mirë e m'u kthy në punë, nuk patën mundësi m'u kthy të gjithë në punë. U kthyen fillimisht 200 punëtorë, UNMIK-u i lejojke qishtu 200 punëtorë. Pastaj gradualisht tu u rrit numri, tu u rrit ka qenë numër i madh. Viteve të '80-ta kjo minierë i ka numërue… miniera me flotacion gjithmonë, se flotacionu u konë në kuadër të minierës, rreth 3200 punëtorë. Po në punë janë kthye fillimisht 200 punëtorë e maksimumi diku 500-600 punëtorë kanë qenë sa kanë qenë këta të vjetrit. Por, tash që janë marrë do gjenerata të reja momentalisht dikun rreth 770 punëtorë i kem, miniera me flotacion.

Anita Susuri: Deshta me ju pyt diçka, se e përmendët pandeminë, po më intereson qysh ka funksionu gjatë karantinës "Trepça"?

Beqir Maliqi: Drejtën me të thonë nuk kena pasë pengesa me lëvizë, edhe pse çdo njeni prej neve e kena marrë nifarë shkrese, nifarë leje të them ashtu që punon në minierën "Trepçe", të vulosne e krejt. Fillimisht kur përhapej me të madhe, ne u organizum edhe i bomë disa regjistra që me reduku numrin, me reduku, pos me lonë… se jonë do pajisje këtu që duhet nonstop me punu, pompat, ventilatori, pusorja. E kështu që e bomë ni regjistër, prej të gjithë atyre diku ka 52 veta na dulën katër ndrrimet për qeto vendet kyçe. Për çdo moment, në qoftë se vjen edhe ndalohet domethonë lëvizja, po nuk pati nevojë nuk e kemi ndërpre punën fare. I kemi pasë të infektum diku krejtësisht diku katër-pesë punëtorë po më duket atje, që jonë izolue. Po në masë të madhe kur dikush në familje për shembull që ju ka smu, është infektue, kanë pushu ata që kanë pas kontakte me te.

Po nuk ka pas najfarë përhapje të madhe, na i ka nxon ni numër i madh edhe jashtë punëtorët, se kanë familjarë e po shkojnë me viza te familjet. Kështu që, jonë kthy edhe ata e kanë kry atë pjesën e karantinës dy javë qysh ka qenë atëherë, po najfarë ndërpremje s'kemë pasë. Po nifarë paniku u konë, nifarë paniku te punëtorët në atë drejtim. Po fatkeqësisht çmimet neve na kanë ra në berza atje, se neve çmimet e metleve caktohen në berzën e Londrës, e na kanë ra çmimet na kanë goditë shumë sa që nuk po mujm me mbijetu, nuk po mujm me majt veten me… Drejtën me thonë, kemi pasë hasë në krizë qatëherë.

Qeveria e Albin Kurtit atëherë na ka pa dhonë ni, ni, ni donacion prej tre million e gjys, po më duket. Sa që kena mujt me tejkalu deri qitu, momentalisht e kemi gjendjen shumë të vështirë, qeto mujt që jemi nuk e di qysh kemi me mujt me dalë prej situate. Se po të mos ishte ai donacioni prej tre milion e gjys, na edhe ma herët do të mbeteshim pa rroga, në qoftë se nuk kish me intervenue. Ka kërkesa edhe të sindikatës edhe atje qeveritë tona drejtë me thonë, nuk po mirren me probleme. Tash qe sa u zgjidh ministri, ai ka duft me ardhë, me pa këtë minierë be, se këtu është pasunia, osht' pasunia. Kur ka mujt qekjo Kosovë, qekjo "Trepçe" me majt Sërbinë e mos të thomë tash Jugosllavinë, ni Kosovë të vogël s'po munët. Po faktikisht kërkujna s'pi intereson ç'a po ndodh, ç'a po bohet, po i kanë problemet e veta, s'ju vjen radha me ardhë te miniera hiç.

Se kjo, kemi menu mas lufte, ka me qenë shtylla ma e madhe ekonomike e Kosovës. Këtu ka vend burime, ka rreth… miniera me rrethinë 10-30 milion tonë xehe, ka plumb, zink, argjent, këtu del ari. Me pa zhvillue, me i zhvillu njësitë tjera, përpunimin, me finalizu këtë xehe po që 20 vite na stagnojmë, pothujse me ni prodhimtari minimale. Prej niqind ma së shumti në 2013-tën, janë prodhue 140 mijë tonë, për dallim po thom viteve '80-ta 700 mijë tonë jonë prodhue, 20 përqindëshi dikun i prodhimit maksimal që ka qenë atëherë. Po jo, drejtën me thonë nuk ka interesim. Nuk e di pse, nuk e di pse ngecum na në këtë drejtim. Na ka çue Zoti këtë pasuni me marrë, me e shfrytëzue, me e zhvillue, me ngritë këtë Kosovë, po nuk po ndodh ni gjo e tillë.

Anita Susuri: Zotëri Maliqi, falemnderit shumë për intervistë! Nëse keni diçka me shtu, nëse jo…

Beqir Maliqi: Jo veç, drejtën me thonë fatkeqësisht penzione… këta e dhanë kontributin minatorët, po edhe ata që kanë shkue s'kanë mujt m'u kthye, po edhe na që po dalum të gjithë në pension domethonë, osht' njifarë ligji atje që na thotë 15 vjet para të '90-tës me qenë kontributdhënës. Shumica e këtyre punëtorëve tash nuk jonë 15 vjet kontributdhënës. Kështu që, po dalin në pension mas krejt këtyne vujtjeve, këtyre kontributeve edhe mas lufte edhe para lufte që i kemi dhonë, po dalin me pension të vjetërsisë me 90 euro pension. Deri qetash qishtu osht' gjendja. Kështu që, paniku i madh në qat' drejtim i ka kap çdo punëtorë që po thojnë, "Për barna nuk na dalin, për barna 90 euro nuk na dalin". Kemi kërkesa me sindikata me, me, me ndryshue diçka në këtë drejtim, premtime ka e në realitet s'ka kurgjo. Po ta shohum po shpresojmë që diçka do të bohet me këtë "Trepçe", se na ka shkue gjatë drejtë me thonë kështu… duhet diçka qeveria, meqenëse është e qeverisë, qeveria duhet me, me, me investu në këtë "Trepçe", me kap me e ngrit, ja me gjetë naj zgjidhje tjetër. Kaq.

Anita Susuri: Mirë. Faleminderit edhe njëherë!

Beqir Maliqi: Faleminderit edhe prej juve. Suksese!